



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I ADMINISTRIMIT PUBLIK DHE SHKENCAVE POLITIKE

TEZA E DISERTACIONIT

**“Kontributi i organizatave ndërkombëtare Islamike në
çështjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”**

Kandidati:

Hasan Asani

Mentori:

Prof.Dr. Jonuz ABDULLAI

Prill, 2018

ABSTRAKT

Ndodhitë e fundit në arenën ndërkombëtare dhe në veçanti në Lindjen e Mesme kanë ngjallur debate të ndryshme si dhe kanë aktivizuar mekanizma të cilët duhet të ballafaqohen me pasojat të dala nga Pranvera Arabe dhe kriza e cila ka përfshirë një numër të madh vendesh të rajonit. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tezës të cilin e kemi parashtruar si objekt hulumtimi, si dhe duke u përqendruar gjithmonë në fakte, si objekt studimi të veçantë do të kemi rolin e Organizatës për Bashkëpunim Islamik si dhe rolin e Ligës Arabe, të cilat në njëfarë mënyre kanë qenë të përfshirë në procesin para dhe pas ngjarjeve të Pranverës Arabe.

Për të arritur deri tek rezultatet e duhura në këtë hulumtim, do të përdorim metodologji hulumtuese të ndryshme, siç është analiza e teksteve të shkruara, dokumenteve zyrtare dhe publikimeve nga hulumtues vendorë dhe atyre ndërkombëtar. Gjithashtu, përdorimi i analizës krahasuese të disa nga mediumeve më prestigjioze të rajonit dhe mënyrën e raportimit të ndodhive të cilat ndërlidhen me objektin tonë të studimit do të plotësojnë këtë punim shkencor. Në mënyrë plotësuese janë përdorur edhe teknikat e veçanta të hulumtimit siç është anketa në teren, rezultatet e së cilës do t'i publikojmë në fund të punimit dhe prej të cilave do të arrijmë deri tek konstatimet dhe rekomandimet tona.

ABSTRACT

The recent events in the international arena and especially in the Middle East have sparked diverse debates and have activated different mechanisms that deal with the consequences of the Arab Spring and the crisis that has involved a large number of countries in the region. Given the sensitivity of the thesis that we have chosen as a field of research, and focusing on facts, as study subjects we will take the role of the Organization for Islamic Cooperation and the role of the Arab League, which in some way have been involved in the process before and after the events of the Arab Spring.

To achieve the desired results in this research, we will use different research methodologies, such as analysis of written texts, official documents, and publications from local and international researchers. Also, the use of comparative analysis of some of the most prestigious media in the region and the way of reporting events that are related to our study object will complement this scientific paper. Additionally, special research techniques are used, such as field surveys, the results of which will be published at the end of the work and from which we will reach our findings and recommendations.

Struktura e punimit

ABSTRAKT	2
LISTA E TABELAVE.....	5
LISTA E FIGURAVE.....	7
LISTA E GRAFIKONEVE	8
LISTA E SHKURTESAVE.....	9
FALËNDERIME	10
I. HYRJE	11
II. KONCEPCIONI ISLAM MBI PAQEN DHE SIGURINË NDËRKOMBËTARE	15
ISLAMI DHE PAQJA	15
Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam	26
Islami dhe globalizimi.....	48
III. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE ISLAMIKE.....	54
Liga Arabe	54
Organizata e Bashkëpunimit Islamik.....	62
IV. ANALIZA E RASTEVE NË KONFLIKTET E BOTËS ARABE	71
Shkaqet që sollën deri tek Pranvera Arabe	80
V. ANALIZA KOMPARATIVE E RAPORTIMIT MEDIATIK MBI SITUATËN NË LINDJEN E MESME DHE AFRIKËN VERIORE.....	95
Al – Jazeera	96
Al – Arabiya	97
TRT	98
Analiza komparative e raportimit mediatik	99
VI. REZULTATET E ANKETËS SË REALIZUAR.....	100
VII. KONKLuzionet	142
BIBLIOGRAFIA	144
SHTOJCA	147

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Moshë e të anketuarve	100
Tabela 2. Gjinia e të anketuarve	101
Tabela 3. Niveli i arsimit i të anketuarve.....	102
Tabela 4. Përkatësia etnike e të anketuarve.....	103
Tabela 5. Përkatësia fetare e të anketuarve	104
Tabela 6. Kontributi i organizatave ndërkombëtare Islamike në çështjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare	106
Tabela 7. Rëndësia e rolit të OKB-së për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë	107
Tabela 8. Rëndësia e rolit të NATO-s për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë	108
Tabela 9. Rëndësia e rolit të OSBE-së për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë.....	110
Tabela 10. Rëndësia e rolit të OBI për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë	111
Tabela 11. Rëndësia e rolit të Ligës Arabe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë	112
Tabela 12. A ekziston ndonjë faktor i cili në mënyrë negative ndikon mbi tolerancën ndërfetare në vend	113
Tabela 13. Faktorët që ndikojnë në mënyrë negative mbi tolerancën ndërfetare në vend	114
Tabela 14. Çka u arrit me Pranverën Arabe?	116
Tabela 15. Sa pajtoheni me qëndrimin "Viteve të fundit konfliktet rajonale kanë ndikuar në përkeqësimin e raporteve fetare mes shteteve ose popujve!"	117
Tabela 16. Sa pajtoheni me qëndrimin "Situata e marrëdhënieve fetare në R. Maqedonisë është duke u përkeqësuar për shkak të konflikteve në Lindjen e mesme?"	119
Tabela 17. Sa pajtoheni me qëndrimin "Bashkësitë Fetare në Maqedoni kanë luajtur rol të rëndësishëm në zvogëlimin e këtyre tensioneve fetare!"	121
Tabela 18. A mendoni se ekziston diçka në Islam që frymëzon sulmet terroriste dhe ato vetëvrasëse, apo kjo ndodh për shkak të keqinterpretimit të mësimave fetare?.....	122
Tabela 19. A mendoni se organizatat si ISIS-i operojnë në emër të Islamit apo kanë ndonjë prapavijë tjetër?.....	124
Tabela 20. A mendoni se formimi i shtetit Islamik (sipas modelit të ISIS-it) është real, apo paraqet një propagandë për përkeqësimin e imazhit të Islamit në botë?.....	125
Tabela 21. Në cilin kategori e kishit vendosur Vëllazërinë Myslimane si lëvizje politike?	126
Tabela 22. A pajtoheni me deklaratimet e Erdoganit për ndryshim të formatit të këshillit të Sigurimit pranë OKB-së se "bota nuk mund të ngelë peng i 5 shteteve anëtare të KS".	127
Tabela 23. Marrëdhëniet ndërkombëtare në mes të Rusisë dhe Amerikës pas ardhjes së Trump-it, a janë në favor të sigurisë dhe paqes botërore?	129
Tabela 24. Në çfarë mase pajtoheni me qëndrimin në vijim: Lufta e Sirisë dhe rasti i refugjatëve është provokim i tensioneve ndëretnike në Evropë!"	130
Tabela 25. Si mendoni se janë trajtuar migrantët Sirian në Maqedoni?	131
Tabela 26. Si mendoni se janë trajtuar migrantët Sirian në Ballkan?	132
Tabela 27. Si mendoni se janë trajtuar migrantët Sirian në Evropë?	134

Tabela 28. Sa mendoni se dëgjohet zëri i Organizatave Ndërkombëtare Islamike në arenën ndërkombëtare, siç p.sh. në rastin e konfliktit të Sirisë?.....	135
Tabela 29. A mendoni se dëgjohet zëri i Organizatave Ndërkombëtare Islamike në vendin tuaj?.....	136
Tabela 30. Çka mendoni se duhet ndryshuar tek funksionimi i Organizatave ndërkombëtare Islamike në mënyrë që të forcohet paqja dhe siguria ndërkombëtare?	138
Tabela 31. A mendoni se ekzistojnë organizata ekstremiste të cilat veprojnë në emër të Islamit në Maqedoni dhe rajon?.....	139
Tabela 32. Sa është i rëndësishëm roli i BFI në ndërtimin e paqes dhe sigurinë në Maqedoni?	140

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Samiti i 35 i Ligës Arabe	61
Figure 2. Harta/ Si është ndarë territori në Siri	77
Figura 3. Moshë e të anketuarve	101
Figura 4. Gjinia e të anketuarve	102
Figura 5. Përkatësia fetare e të anketuarve.....	105
Figura 6. A ekziston ndonjë faktor i cili në mënyrë negative ndikon mbi tolerancën ndërfetare në vend	114
Figura 7. Faktorët që ndikojnë në mënyrë negative mbi tolerancën ndërfetare në vend	115
Figura 8. A mendoni se ekziston diçka në Islam që frymëzon sulmet terroriste dhe ato vetëvrasëse, apo kjo ndodh për shkak të keqinterpretimit të mësimave fetare?.....	123
Figura 9. A mendoni se organizatat si ISIS-i operojnë në emër të Islamit apo kanë ndonjë prapavijë tjetër?.....	124
Figura 10. A mendoni se formimi i shtetit Islamik (sipas modelit të ISIS-it) është real, apo paraqet një propagandë për përkeqësimin e imazhit të Islamit në botë?	125
Figura 11. A pajtoheni me deklaratimet e Erdoganit për ndryshim të formatit të këshillit të Sigurimit pranë OKB-së se “bota nuk mund të ngelë peng i 5 shteteve anëtare të KS”.	128
Figura 12. Sa mendoni se dëgjohet zëri i Organizatave Ndërkombëtare Islamike në arenën ndërkombëtare, siç p.sh. në rastin e konfliktit të Sirisë?.....	135
Figura 13. A mendoni se dëgjohet zëri i Organizatave Ndërkombëtare Islamike në vendin tuaj?.....	137
Figura 14. A mendoni se ekzistojnë organizata ekstremiste të cilat veprojnë në emër të Islamit në Maqedoni dhe rajon?.....	139
Figura 15. Sa është i rëndësishëm roli i BFI në ndërtimin e paqes dhe sigurinë në Maqedoni?	141

LISTA E GRAFIKONEVE

Grafikoni 1. Niveli i arsimit i të anketuarve	103
Grafikoni 2. Përkatësia etnike e të anketuarve.....	104
Grafikoni 3. Kontributi i organizatave ndërkombëtare Islamike në çështjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare	106
Grafikoni 4. Rëndësia e rolit të OKB-së për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë	108
Grafikoni 5. Rëndësia e rolit të NATO-s për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë.....	109
Grafikoni 6. Rëndësia e rolit të OSBE-së për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë.....	110
Grafikoni 7. Rëndësia e rolit të OBI për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë	111
Grafikoni 8. Rëndësia e rolit të Ligës Arabe për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në rajon dhe botë	113
Grafikoni 9. Çka u arrit me Pranverën Arabe?	116
Grafikoni 10. Sa pajtoheni me qëndrimin "Viteve të fundit konfliktet rajonale kanë ndikuar në përkeqësimin e raporteve fetare mes shteteve ose popujve!"	118
Grafikoni 11. Sa pajtoheni me qëndrimin "Situata e marrëdhënieve fetare në R. Maqedonisë është duke u përkeqësuar për shkak të konflikteve në Lindjen e mesme?"	120
Grafikoni 12. Sa pajtoheni me qëndrimin "Bashkësitë Fetare në Maqedoni kanë luajtur rol të rëndësishëm në zvogëlimin e këtyre tensioneve fetare!"	122
Grafikoni 13. Në cilin kategori e kishit vendosur Vëllazërinë Myslimane si lëvizje politike?	127
Grafikoni 14. Marrëdhëniet ndërkombëtare në mes të Rusisë dhe Amerikës pas ardhjes së Trump-it, a janë në favor të sigurisë dhe paqes botërore?	129
Grafikoni 15. Në çfarë mase pajtoheni me qëndrimin në vijim: Lufta e Sirisë dhe rasti i refugjatëve është provokim i tensioneve ndëretnike në Evropë!"	131
Grafikoni 16. Si mendoni se janë trajtuar migrantët Sirian në Maqedoni?	132
Grafikoni 17. Si mendoni se janë trajtuar migrantët Sirian në Ballkan?	133
Grafikoni 18. Si mendoni se janë trajtuar migrantët Sirian në Evropë!"	134
Grafikoni 19. Çka mendoni se duhet ndryshuar tek funksionimi i Organizatave ndërkombëtare Islamike në mënyrë që të forcohet paqja dhe siguria ndërkombëtare?	138

LISTA E SHKURTESAVE

BE	Bashkimi Evropian
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
NATO	North Atlantic Treaty Organization
OKI	Organizata e Kongresit Islam
OBI	Organizata e Bashkëpunimit Islam
LSHA	Liga e Shteteve Arabe
BFI	Bashkësia Fetare Islame

FALËNDERIME

Puna të cilën e kam realizuar gjatë hulumtimit të disertacionit tim ka qenë e lodhshme me plot emocione dhe dilema. Falë përkrahjes nga familja ime dhe sidomos mentorit tim Prof.Dr. Jonuz Abdullait që përmes takimeve të shpeshta më ka orientuar gjatë hulumtimit tim, kam arritur deri në përfundim të këtij punimi.

I. HYRJE

Ndodhitë e fundit në arenën ndërkombëtare dhe në veçanti në Lindjen e Mesme kanë ngjallur debate të ndryshme si dhe kanë aktivizuar mekanizma të cilët duhet të ballafaqohen me pasojat të dala nga Pranvera Arabe dhe kriza e cila ka përfshirë një numër të madh vendesh të rajonit. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e tezës të cilin e kemi parashtruar si objekt hulumtimi, si dhe duke u përqendruar gjithmonë në fakte, si objekt studimi të veçantë do të kemi rolin e Organizatës për Bashkëpunim Islamik si dhe rolin e Ligës Arabe, të cilat në njëfarë mënyre kanë qenë të përfshirë në procesin para dhe pas ngjarjeve të Pranverës Arabe.

Punimi në fjalë trajton rolin e Organizatave Ndërkombëtare Islamike, në skenën ndërkombëtare me theks të veçantë, rolin e tyre në ruajtjen dhe promovimin e paqes në botë si dhe të drejtat themelore të njeriut. Ndikimi i këtyre organizatave është i diskutueshëm nga shkak se në kuadër të tyre përfaqësohet një popullatë me afër 2 miliard banorë. Me ndryshimet e fundit, shtetet arabe po kalojnë në një fazë revolucionare, duke ndryshuar sistemet e tyre politike dhe ndikimin e tyre në skenën ndërkombëtare. Përveç ndryshimit të sistemit politik, tek popullata e atyre vendeve ndodh edhe ndryshimi në mënyrën e të menduarit dhe qasjes ndaj pushteteve.

Ndikimi i faktorit islam në marrëdhëniet ndërshtetërore dhe bashkëpunimi midis vendeve muslimane në veçanti doli në pah gjatë katër dekadave të kaluara, përmes veprimit të Organizatave Ndërkombëtare Islamike. Prandaj, mes tjerash, është e nevojshme që të përshkruhen dhe shpjegohen sa më gjerësisht duke marrë në konsideratë tërësinë e proceseve aktuale ndërkombëtare. Organizatat Ndërkombëtare Islamike kanë luajtur rolin e tyre gjatë zgjidhjes së konflikteve, por efekti i tyre duhet të vërtetohet edhe më tej.

Qëllimi kryesor ku do të përqendrohem do të jetë siguria ndërkombëtare, respektivisht roli i Organizatave Ndërkombëtare Islamike në zgjedhjen paqësore të konflikteve. Gjithashtu do të japim edhe të dhëna që lidhen me Lindjen e Mesme, të cilat synojnë të ndryshojnë karakteristikat dhe të bëjnë vendosjen e një rendi të ri rajonal i ashtuquajtur projekt i ri në Lindjen e Mesme. Për këtë shkak edhe kemi përzgjedhur hipotezën kryesore e cila do të shërbejë si bosht rreth së cilës do të ndërlihim analizat dhe të dhënat e dala nga hulumtimi, ndërsa

hipotezat ndihmëse në rastin tonë do të plotësojnë njëra-tjetrën dhe do të japin informata relevante.

Hipoteza kryesore:

- Organizatat Islamike kanë ndikim të vogël në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në zgjidhjen e konflikteve në rajon.

Hipotezat ndihmëse

- Mungon bashkëpunimi i Organizatave Islamike me organizatat tjera ndërkombëtare për sigurimin e stabilitetit dhe sigurisë në botë.
- Bashkëpunimi me asociacionet tjera ndërkombëtare dhe lufta kundër terrorizmit është një ndër preokupimet kryesore të Organizatave Islamike.

Natyra e temës që do të hulumtohet kërkon zbatimin e metodave dhe teknikave të ndryshme shkencore hulumtuese. Në këtë punim hulumtues do të përdoren disa prej metodave të përgjithshme shkencore siç janë: Metoda Deskriptive – Historike, Metoda – Analitike; Metoda – Krahasese; Metoda Kauzale – shkak pasojë si dhe anketa e realizuar në teren.

Nga shkak se tema në fjalë është shumë pak e trajtuar nga studiues shqiptarë, jemi të mendimit se punimi do të shpalos fakte për të cilat opinioni më i gjerë nuk ka njohuri të mjaftueshme si dhe do të kontribuoj në sqarimin e situatës momentale, respektivisht ndryshimet politike që ndodhin në Lindjen e Mesme dhe në rajon.

Rëndësia e veçantë e punimit është gjurmimi rreth revolucioneve së Pranverës Arabe, ku do të shpjegohen hollësisht motivet dhe arsyet dhe cilët janë ndryshimet e tyre që ndodhin në botën arabe islame, e që sot konsiderohet si epiqendra e konflikteve ndërkombëtare. Si rezultat nga hulumtimi është përfitimi i njohjes reale për atë se çka po ndodh në botën arabe, shpërthimet e regjimeve politike, gjithnjë duke e përfshirë këtë në pikat kryesore si në vijim.

- Përmbledhje e të dhënave me materiale shkencore për të formuar një ide të plotë në ndodhitë e ngjarjeve që ndodhin në lindjen e mesme ndryshimet politike posaçërisht revolucionet e pranverës arabe në një mënyrë sistematike .

- Përfundimi dhe prezantimi i këtij studimi si një përpjekje e vërtetë dhe serioze për të shtuar një studim të ri në shkencat politike në lidhje mbi ngjarjet aktuale që ndodhin në lindjen e mesme.
- Rezultatet e pritura në përgjithësi do të japin përgjigje specifike për pyetjet të cilat janë shtruar si hipoteza.

Për sa i përket strukturimit të këtij disertacioni, ai përbëhet prej shtatë kapitujve. Në kapitullin e parë jepet pjesa hyrëse e punimit ku cekën motivet, qëllimet dhe objektivat e hulumtimit. Krahas hipotezës kryesore dhe atyre ndihmëse jepet edhe një rishikim të literaturës, të publikimeve të mëhershme të cilat kanë të bëjnë me temën në fjalë, në veçanti të atyre publikimeve të cilat janë shkruar në gjuhën shqipe.

Në kapitullin e dytë, i cili titullohet koncepti islam mbi paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, trajtohet nocioni i Islamit dhe paqes, çka të tjerët flasin për Islamin, ofrohen të dhëna të shumta në lidhje me këtë temë, si dhe cekën shumë publikime nga autorë vendor dhe ndërkombëtarë të vilët e kanë trajtuar temën në fjalë. Më tej në këtë kapitull sqarohen marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, përmes shembujve të shumtë, gjithnjë duke u bazuar në legjislacionin dhe praktikën Islame. Në fund të këtij kapitulli sqarohet çështja e Islamit dhe globalizimit, ndikimi i tyre i ndërsjellë dhe efektin të cilin ato e kanë në këshën e sotit.

Në kapitullin e tretë do të japim të dhëna për organizatat ndërkombëtare Islamike, ku si shembull e kemi marrë Organizatën e Bashkëpunimit Islamik dhe Ligën Arabe. Në këtë pjesë do të japim një pasqyrë historike për shkaqet e paraqitjes së këtyre organizatave, strukturimin e tyre dhe rolin të cilin këto organizata e kanë në ruajtjen e paqes botërore. Të dhënat të cilat do të nxiren nga analiza e teksteve dhe dokumenteve zyrtare do të na japin informacion dhe një pasqyrë më të qartë për mënyrën e funksionimit të këtyre organizatave.

Në kapitullin e katërt vijon analiza e rasteve të konflikteve në botën Arabe, ku në veçanti do të elaborohen shkurtimisht të gjitha vendet të cilat ishin të përfshirë në Pranverën Arabe. Gjithashtu do të tentojmë t'i identifikojmë edhe shkaqet të cilët sollën deri tek këto zhvillime, të cilët tronditën rajonin dhe botën në përgjithësi.

Në kapitullin e pestë do të paraqesim një analizë komparative të raportimit mediatik të disa nga ndodhjet më me rëndësi në botën Islame, edhe atë nga disa nga mediet më të njohura botërore. Analiza e raportimit të ndodhjeve ndodh në një periudhë të caktuar kohore, në të cilën janë analizuar burimet elektronike të medimeve siç janë: Al-Jazeera e Katarit, Al-Arabiya e Arabisë Saudite dhe TRT e Turqisë.

Në kapitullin e gjashtë do të shpalosen rezultatet e anketës së realizuar në teren. Këto rezultate do të shfaqen në formë të tabelave, grafikoneve dhe figurave, me anë të cilave do të lehtësohet analiza e të dhënave.

Në kapitullin e fundit paraqiten konstatimet nga hulumtimi i realizuar dhe jepen rekomandimet të cilat duhet të shërbejnë si një udhërefyes për studiuesit e ardhshëm në këtë fushë studimi e cila gjithnjë e më shumë bëhet e domosdoshme të njihet nga hulumtuesit e shkencave shoqërore.

II. KONCEPCIONI ISLAM MBI PAQEN DHE SIGURINË NDËRKOMBËTARE

ISLAMI DHE PAQJA

Fetë nuk thërrasin për dhunë. Bazat e mësimave të tyre janë paqësore. Boshti i tyre sillet rreth rivendosjes së harmonisë fillestare mes parajsës dhe tokës, mes Krijuesit dhe krijimit. Mirëpo, për përfitime të caktuara politike, disa mësimet dhe ndjesi të veçanta të tyre manipulohen. Dhuna ushtrohet në emër të fesë, por nuk falet nga ajo. E vetmja kritikë që mund të ngrenë shekullaristët (e që mund të qëndrojnë) është se fetë nuk kanë zhvilluar mburoja për t'u mbrojtur nga këto abuzime e manipulime. Siç ka treguar dhe Juergensmeyer-i në studimin e tij të gjithanshëm për dhunën fetare në epokën moderne, dhuna nuk njihet kufij fetarë dhe kulturor. Ajo mund të gjejë strehë si në mësimet që nuk janë armiqësore, ashtu edhe në ato më sublimet. Sidoqoftë, fetë mbeten vulnerabël kur dështojnë të gjeturi mënyra për të parandaluar përdorimin e forcës në emër të tyre. Kjo bëhet akoma më e ndjeshme kur ato dështojnë të nguliturit në mendjet dhe zemrat e ndjekësve të tyre vetëdijen e paqes dhe mënjanimin e dhunës.¹

Trajtimi i materialeve për shoqëritë bashkëkohore muslimane në lidhje me paqen, me diversitetin fetar dhe drejtësinë shoqërore kërkon vëmendje urgjente. Prandaj, sfida e shoqërive bashkëkohore muslimane nuk është vetëm t'i trajtojë këto çështje si pjesë e problemeve të brendshme, por edhe të kontribuojë në lëvrimin e kulturës globale të paqes dhe bashkëjetesës. Por, përpara se të shkojmë te tradita islame, duhet të themi një dy fjalë për ta bërë të qartë kuptimin e paqes pozitive. Paqja si koncept i pavarur dhe pozitiv kërkon praninë e disa kushteve të atilla që ta bëjnë atë një gjendje të qëndrueshme harmonie, integriteti, përmbajtjeje, ekuilibri, prehjeje dhe drejtësie. Kjo mund të vendoset në kontrast me paqen negative, që paraqet mungesën e konfliktit dhe mosmarrëveshjeve. Megjithatë paqja negative është e domosdoshme për të shmangur dhunën shoqërore, konfliktet kufitare ose ato ndërkombëtare, paqja pozitive thërret në një perspektivë më të plotë, ku të adresohen konfliktet më të thella: urrejtja, lufta, shkatërrimi, brutaliteti dhe dhuna. Siç thotë edhe Lee, ajo siguron gjithashtu edhe një matje të

¹ GH.Muhammad & I.Kalin & M.Kamail, Lufta dhe paqja në Islam, Logos – A, Shkup, 2015, f.308

vërtetë dhe një set vlerash ku paqja dhe drejtësia mund të vendosen përtej interesave afatshkurtra të individëve, komuniteteve dhe shteteve. Kjo është kritike për ndërtimin e paqes si vlerë e pavarur, pasi përcaktimi i paqes si privim nga dhuna dhe konflikti shndërrohet në një koncept që në rastin më të mirë është instrumental dhe aksidental; ndërsa në rastin më të keq është relativ dhe i pavend.² Më tej, kuptimi pozitiv dhe i pavarur i paqes e zhvendos vëmendjen nga parandalimi i konfliktit, dhunës e mosmarrëveshjes drejt gatishmërisë për të prodhuar ekuilibër, drejtësi, bashkëveprim, dialog dhe bashkëjetesë. Në vend që të përkufizojmë paqen dhe të imponojmë një kuptim për kufijtë e saj, ne zgjedhim të krijojmë një terren filozofik bazuar në prani dhe durim, dhe jo bazuar në mungesën e disa cilësive dhe kushteve të caktuara që e bëjnë paqen një realitet të pavarur në jetën njerëzore. Gjithashtu, drejtimi i diskursit të paqes te konflikti shoqëror dhe parandalimi i tij sjell rrezikun e mospërfilljes së individit, që është dhe një *conditio sine qua non* për paqen e përbashkët. Ky është dhe momenti kur "individualizmi shpirtëror" i Islamit versus kolektivizmi shoqëror sjell kuadrin: individit duhet të jetë i pajisur me cilësitë e nevojshme që e bëjnë paqen realitet të qëndrueshëm, jo vetëm në sferën publike, por edhe në domenin vetjak. Paqja si vlerë themelore zgjerohet në domenin etik dhe moral, pasi këto janë ndër kushtet që sjellin paqe në shpirt dhe që i rezistojnë ngasjeve të mosmarrëveshjes, të nervozizmit, shëmtisë, zemërngushtësisë dhe vulgaritetit.

Collingwood-i thotë se paqja është një "fakt darnik" që kërkon vetëdije dhe kujdes; është një gjendje e qëndrueshme ndërgjegjeje ku njeriu duhet të përfshihet nëpërmjet xhihadit shpirtëror dhe intelektual, për t'u siguruar se ndryshimet dhe konfliktet e brendshme apo të traditave përreth të mos përbëjnë kërcënim për dhunë apo shtypje. Paqja pozitive kërkon edhe analizën e formave të ndryshme të agresionit, përfshirë këtu atë individual, institucional dhe dhunën e strukturuar. Paqja bazohet edhe në drejtësi, pasi paqja predikohet edhe si disponueshmëri e të drejtave të barabarta dhe e mundësive që të gjithë të realizojnë qëllimet dhe ambiciet e tyre. Një nga kuptimet e fjalës "drejtësi" në arabishte është edhe "të jesh i drejtë dhe i paanshëm", "të jesh i thjeshtë, besës dhe i paanshëm në marrëveshjet me të tjerët". Një sjellje e tillë krijon situatën e ekuilibrit, të mirëkuptimit dhe të besimit, elemente të cilat shkojnë përtej drejtësisë formale të zbatuar nga sistemi juridik. Në kuptimin e gjerë, drejtësia përfshin një domen shumë të madh të marrëdhënieve dhe ndërveprimeve, që nga kujdesi vetjak për trupin e

² GH.Muhammad & I.Kalin & M.Kamail, *Lufta dhe paqja në Islam*, Logos – A, Shkup, 2015, f.315

deri te ligji ndërkombëtar. Ashtu si paqja, edhe drejtësia është një nga emrat hyjnorë. Ajo mban një rëndësi mjaft të veçantë në përputhje me rolin qëndror që ka në teologjinë islame, sikurse edhe në vetë ligjin islam.³

Rregullat e sheriatit që lidhen me luftën, paqen, xhihadin, minoritetet fetare dhe me ndarjet fetaro-politike përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ligjit Islam të kombeve. Interpretimi i tyre kontekstual dhe historik përfaqëson një sfidë të rëndësishme për dijetarët e Islamit në njërën anë, dhe vetë muslimanët në anën tjetër. Në analizën e këndvështrimeve të juristëve për këto çështje nga shekulli i dytë islam e tutje, vërehet se ka një prirje të përgjithshme për të ngulitur disa rregullime specifike ligjore në këndvështrimin ortodoks të Islamit, që është i zbatueshëm në të gjitha kohët dhe hapësirat. Ndërsa është pranuar se ligji islam bazohet në autoritetin përfundimtar të Kurianit dhe Sunetit, sheriatit si kod ligjor është strukturuar në një mënyrë të atillë që u lejon liri komuniteteve dhe dijetarëve muslimanë që të përshtaten sipas kohëve dhe rrethanave të ndryshme. Brezat e parë të dijetarëve muslimanë, juristët (fukaha), interpretuesit e Kurianit (mufessirun), tradicionalistët (muhaddithun) dhe historianët e kanë përdorur gjerësisht këtë të drejtë, duke krijuar kështu mjedis të përshtatshëm për krijimin dhe lulëzimin e disa shkollave dhe mendimeve ligjore në Islam. Gjithsesi, kjo natyrë elastike e sheriatit nuk është shprehur e as nuk është vënë në pah as nga studiuesit perëndimorë, as nga bota islame. Në kontekstin tonë, kjo ka sjellë përfundimin e stërthënë se mësimet e sheriatit (dhe si pasojë ato të Islamit) nuk kanë siguruar një koncept themelor të paqes dhe as një kulturë bashkëjetese.⁴

Në kuptimin e parë, xhihadi është zgjatim i traditës jus ad bellum, dhe mund të shihet si nevojë për të mbrojtur drejtësinë, lirinë dhe rendin. Në këtë kuadër, qëndrimi që mban Kur'ani dhe Profeti për përdorimin e forcës kundër shtypjes së muslimanëve dhe jomuslimanëve, në thelb është një qëndrim realist dhe synon të vendosë kushte të rrepta në lidhje me luftën dhe përdorimin e forcës. Parimi themelor është që të luftohet kundër agresionit, që është "lufto në rrugën e Zotit" dhe mos ji agresiv: "Luftoni (katilu - "vrit") në rrugën e Allahut ndaj atyre që luftojnë kundër jush, por mos e kaloni kufirin, se Allahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin." (El-Bekare, 190; shih edhe En-Nisa, 91; Et-Teube, 36) Si interpretuesit klasikë ashtu edhe ato modernë kanë thënë për urdhrin "mos e kaloni kufirin" (la tagtedu) se, në fillim, duhet shmangur

³ GH.Muhammad & I.Kalin & M.Kamail, Lufta dhe paqja në Islam, Logos – A, Shkup, 2015, f. 316-317

⁴ Po aty, f. 331

lufta dhe armiqësia, dhe të shkohet drejt luftës së armatosur vetëm për të mbrojtur lirinë, dhe kur të jetë e detyrueshme të luftohet; si dhe duhet të ruhet jeta e joluftëtarëve (ku përfshihen gratë, fëmijët dhe të moshuarit).⁵

Për ta sjellë më mirë gjerësinë e teologjisë islame në lidhje me paqen dhe diversitetin kulturor, na duhet të shohim qëndrimet kulturore dhe zakonet e shoqërive muslimane me komunitetet e tjera, të cilat po kthehen tani. Islami nuk orienton drejt një forme të veçantë identiteti kulturor. Për këtë ka arsye doktrinale dhe historike. Mungesa e një autoriteti qendror fetar ose e klerit në traditën islame, zvogëlon autoritarizmin si një model i bisedimit të çështjeve fetare në sferën publike. Kjo është dëshmuar nga shumëllojshmëria e shkollave ligjore, si dhe nga ndryshimet e qëndrimeve midis tyre. Ky fakt, shpesh i përmendur me krenari nga muslimanët, nuk e hedh poshtë praninë e këndvështrimeve që janë pranuar gjerësisht në traditën islame. Pretendimi se ka një set besimesh dhe praktikash që kryesisht përbëjnë një rrjedhë të përgjithshme dhe ortodokse, bazohet më shumë në konsensusin e komunitetit ndër breza sesa në një trup i centralizuar rregullimesh ligjore. Përsheptimi i procesit të vendosjes së etiketave ortodokse nuk është monopol i ulemasë. Në fakt, ky proces formësohet nga një shumësi agentësh shoqërorë, si njerëzit e letrave, dervishët, evlijatë, "heretikët", rapsodët dhe këngëtarët popullorë, historianët, udhëheqësit politikë, ligjvënësit, shkencëtarët, artistët, tregtarët, diplomantët, filozofët dhe teologët. Në kohën kur propagandimi i autoritetit shoqëror në njërin anë dhe farkëtimi i shprehive kulturore të shoqërive muslimane në anën tjetër ka sfiduar centralizimin dhe autoritarizmin, është ngritur dyshimi i legjitimitetit dhe autenticitetit. Disa vehabitë dhe orientalistë e kanë quajtur këtë devijim nga normat e fesë, duke thënë se historia islame nuk ka qenë aq shumë islame sa antinomiane. Megjithatë e pranojmë se ka mospërputhje të hapura midis asaj që ulemaja mendon si shariat perfekt dhe kulturës e zakoneve të shoqërive muslimane, mendojmë se ky është një tension i shëndetshëm dhe se kjo gjë funksionon si mekanizëm kontrollesh dhe balancash kundër qasjeve të juristëve që mund të bazohen në mënyrë shumë strikte nëpër tekste, që mund të jenë relativisht abstrakte apo që mund ta dobësojnë aspektin ligjor. Gjatë krijimit të zakoneve kulturore, komunitetet muslimane kanë vepruar gjithmonë brenda një kornize të universalitetit etik të Kur'anit dhe Sunetit. Thirrja kur' anore për t'ju bashkuar asaj që është e mirë dhe e lejuar dhe për të ndaluar atë që moralisht është e keqe dhe

⁵ GH.Muhammad & I.Kalin & M.Kamail, Lufta dhe paqja në Islam, Logos – A, Shkup, 2015, f. 339

e papëlqyeshme, nuk është një urdhëresë specifike kulturore. Kjo thirrje i adresohet të gjithë njerëzve, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare. Profeti është konsideruar shembulli perfekt i luftëtarit kundër asaj që është e keqe dhe shtypëse, dhe i mbrojtësit të asaj që është e lavdërueshme dhe e virtytshme. Shembulli i tij vlen për të gjithë njerëzimin. Qëllimi i këtij universaliteti etiko-shpirtëror nuk është të formojë një shoqëri që trashëgon traditat e fisit, të qytetit apo kombit, por një shoqëri të gjerë që bazohet në vlera morale.⁶

Shembujt e historisë së kulturës islame nuk janë të pakët dhe nuk bien ndesh me normat. Megjithëse fundamentalistët thonë se rastet e simbiozave dhe të sinkretizmit në botën islame janë devijim nga forma ideale dhe ideologjike e Islamit, intelektualët tradicionalë dhe shoqëritë muslimanë e kanë parë paqen në prizmin e shkëmbimit kulturor dhe shoqëror. Analiza e mirë e konceptit islam për paqen shkon përtej përkufizimit të ngurtë të paqes si mungesë e konfliktit, si dhe përtej sferës së kufizuar të ligjit. Në një kuptim të gjerë, tradita islame ka treguar se koncepti i paqes shtrihet nga metafizika dhe kozmologjia të ligji dhe kultura. Pa marrë parasysh këto elemente, nuk mund ta kuptojmë përvojën e shoqërive muslimane me kulturën dhe fetë të tjera. Lidhja e kësaj tradite me botën e sotme muslimane kërkon pak shpjegim. Sot, shumë intelektualë, studiues dhe udhëheqës nga Bosnja, Turqia, Egjipti, Irani, Malajzia dhe SHBA-ja janë angazhuar për të ndërtuar një etikë politike islame që krahasohet me traditën islame dhe që i përgjigjet sfidave të botës moderne. Çështjet e luftës dhe paqes, të dhunës shoqërore, të terrorizmit, të marrëdhënieve ndërkombëtare, të demokracisë konstitucionale dhe pjesëmarrëse, të pluralizmit, të sinqeritetit, të qytetarisë dhe të qëndrimit karshi feve të tjera, po diskutohen sipas një morie perspektivash. Këndvështrimet që shpalosen nuk është e thënë që të jenë të njëjta dhe homogjene. Gjithsesi, ka një konsensus të dukshëm për ta trajtuar paqen si vlerë në vetvete, pavarësisht gjendjes politike të vendeve muslimane dhe të komuniteteve të ndryshme nëpër botë. Si përfundim, duhet të shpjegojmë domethënien e këtij konsensusi sipas kontekstit ku ndodhemi. Komunitetet muslimane nuk mund të adresojnë çështjet e konfliktit dhe të dhunës pa përpunuar etikën e duhur të paqes. Shumica e konflikteve sektare në botën islame mund të zgjidhen në rrugë paqësore, por mungesa e një debati konstruktiv që zhvillohet midis studiuesve, udhëheqësve, aktivistëve dhe agjencive shtetërore heq çdo mundësi për të parandaluar mosmarrëveshjet shoqërore dhe përdorimin e forcës. Në kohët kur ne jetojmë, konfliktet janë

⁶ GH.Muhammad & I.Kalin & M.Kamail, Lufta dhe paqja në Islam, Logos – A, Shkup, 2015, f. 348

lokale dhe globale. Nuk mund të flasim më për konfliktet lokale dhe kombëtare pa marrë parasysh lidhjet ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të mos marrim parasysh ndikimin e prirjeve globale për probleme të ndryshme lokale. Problemi i Kashmirit ose konfliktit Izrael-Palestinë kundërshtojnë hapur konceptet tradicionale të diskutimeve ndërshtetërore dhe/ose territoriale. Kjo përfaqëson një sfidë të veçantë për mendimin politik bashkëkohor islam përgjatë tranzicionit të tij që nga unitetet e mëdha politike të Perandorisë. Gjithashtu kjo është një sfidë edhe për plejadën e shteteve në sistemin e sotëm të komb-shteteve në njërën anë, si dhe për globalizimin në anën tjetër. Mbetet për t'u parë se çfarë do t'i sjellë shoqërive muslimane modeli i dobësuar i komb-shteteve, si dhe ç'ndikim do kenë këto në rrugëtimin e muslimanëve për t'u përballur me sprovat ekonomike dhe globalizimin kulturor. Sidoqoftë, përvetësimi i kulturës së paqes është një nevojë urgjente për komunitetet muslimane, nevojë që pasqyrohet në ndërlidhjet shoqërore dhe te marrëdhëniet me shoqëritë e tjera.⁷

Koncepti i sealm-it "paqe" /"siguri" , që ka nisur të përdoret në fillimet e Islamit, është shqyrtuar përsëri duke u bazuar në materialet e hershme gjuhësore të Kur'anit dhe Hadithit. Vlera më thelbësore në zemrën e Islamit mund të përkufizohet si "siguri"/"paqe". Edhe tani, mësimet islame për paqen janë të aktualizuara sipas arsytimit bashkëkohor për sigurinë njerëzore, që shihet si një zhvillim më i madh dhe si përmbushje e nevojave shoqërore. Shtysa dyfishe e arsytimit islam për paqen është e dukshme: shoqërore dhe e përbashkët, individuale dhe shpëtimtare. Çështja e sigurisë njerëzore gjen mbështetje të gjerë te mendimi dhe përvoja islame. Në gjendjen e nënshtrimit të jashtëm dhe dorëzimit të brendshëm, feja islame fillimisht u shpërfaq dhe u kuptua si një praktikë shpëtimtare për paqe. Por, sot, kjo thënie është vënë në dyshim nga shumë jomuslimanë, të cilët theksojnë rolin luftëtar të një besimi luftues që synon pushtim dhe dominim. Ky është një perceptim mesjetar evropian, që tashmë është kultivuar në institucione inteligjence dhe sigurie kundër terrorizmit. Si duhet ta kuptojmë kontekstin origjinal dhe domethënien e paqes në Islam? Siç trashëgohet nga historia, kuptimi i saj lidhet me sigurinë. Kjo lidhje mund të na ndihmojë të japim qëllimin dhe përmbajtjen e botëkuptimit autentik islam për paqen. Tani e kemi të përshtatshme të marrim parasysh rolin e fesë për të siguruar njeriun. E

⁷ GH.Muhammad & I.Kalin & M.Kamail, Lufta dhe paqja në Islam, Logos – A, Shkup, 2015, f. 357-358

kemi fjalën për sigurinë njerëzore në marrëdhënie simbioze me zhvillimin, me sigurinë dhe studimet konfliktuale, përfshirë këtu paqen dhe zgjidhjen e konflikteve.⁸

Problemi i interpretimeve ekstremiste të Islamit është një problem tekstual dhe metodologjik, që kërkon një zgjidhje po tekstuale dhe metodologjike. Askush nuk kryen veprime terroriste pa qenë i bindur se terrorizmi lejohet. Arritja në përfundimin se terrorizmi lejohet, kërkon një fetva. Ndërkohë që një fetva të tillë mund ta japë vetëm dikush që është i gatshëm të shtrembërojë tekstet dhe të anashkalojë metodologjitë e ligjit klasik islam. Interpretimet ekstremiste të Islamit dhe dhuna që i ndjek ato, mund të çrrënjosen vetëm duke u çrrënjosur vullneti për të shkakuar vorbulla ekstremiste. Deklarata e fundit e konferencës së Amanit dhe përmbledhja e fetvave që u hartuan në funksion të kësaj konference ishin një hap kyç për "luftën kundër terrorizmit", ku muslimanët dhe jomuslimanët mund të punojnë dorë për dorë.⁹

Ekspertë ose analistë me prejardhje myslimane, që kanë jetuar në botën perëndimore, janë munduar të japin kontributin e tyre, duke ofruar modele dhe mënyra të reja të qeverisjes. Kështu, analisti Timur Kuran mendon se islami as nuk është problemi e as zgjidhja e problemit, ai analizën e tij e fillon me Vëllazërit Myslimanë dhe thotë: "Vëllazëria Myslimane ka përdorur shpesh sloganin "Islami është zgjidhja". Dhe në Perëndim, ndjenja të panjohura në kërkim të gjithë peizazhit të zymtë të Lindjes së Mesme ka qenë shpesh: "Islami është problemi". Hulumtimi profesorit Kuran sugjeron se, së paku në kohë të afërt, pikëpamja më e saktë është: Islami nuk është problemi dhe nuk është zgjidhja, Islami është thjeshtë një fe – do të thotë se faza e ngecjes është kapërcyer, nuk ka justifikime dhe është koha për të ecur përpara përsëri".

Islami në emër të lirisë së individit, ua njeh të drejtën individuale dhe kolektive të gjithë atyre që mendojnë ndryshe nga myslimanët, duke filluar për të besuar lirshëm dhe të drejtën e shprehjes, të drejtën e punës dhe të sjelljes në publik si dhe të drejtën politike.¹⁰ Në përmbyllje të kësaj, mendimtari egjiptian Mahmud Sheltut (1893-1963), rreth tolerancës së Islamit, shprehet: "Kur bëhet fjalë për natyrën e Islamit, vërehet se kemi të bëjmë me fenë që posedon lirinë e shprehjes dhe mendimit. Ai nuk ndalon vetëm brenda parimeve të tij bazike dhe juridike të ngjyrës së tij, por në emër të lirisë ai i njeh idetë dhe programet e mendimeve të feve të tjera që

⁸ GH.Muhammad & I.Kalin & M.Kamail, *Lufta dhe paqja në Islam*, Logos – A, Shkup, 2015, f. 359-360

⁹ Po aty, f. 470-475

¹⁰ EBU ZEHRE, Muhamed, *"Sisitemi Islam në shoqëri"* Darul el Fikr el Arabi, Kajro 1999, f.141

përmbajnë parime të sakta, si në kulturë ashtu edhe në dobi të zhvillimit të civilizimit dhe mirëqenies njerëzore.¹¹

Islami nuk duhet të kuptohet se është sistem monist. Demokracia liberale mund të thuhet se ka elemente prej të cilave myslimanët do të duhej të afroheshin për diskutime konstruktive. Islami, fatkeqësisht, është keqkuptuar nga shumë 'studiues', ose më mirë të thuhet, ai në realitetet asnjëherë nuk është i njohur sa duhet nga jomyslimanët. Mendimtari gjerman Hubermas kujton disa të dhëna dhe sjellje të hidhura nga evropianët dhe thotë; "Islamofashizmi" i krijuar është po aq pak një kundërshtar evident siç është një "luftë": lufta kundër terrorizmit. Të ne në Evropë, realizimi i normave është premisë e padiskutueshme e bashkëjetesës, saqë thirrja hysterike për mbrojtjen e "vlerave" tona duket si armatosja semantike kundër një armiku të brendshëm të panjohur.¹²

Dallimi midis Islamit dhe demokracisë liberale fillon që në perceptimet e para konceptuale. Islami për bazë ka besimin në Krijuesin e universit, dhe njeriun besimtarë. Strukturat udhëheqëse nxirren mbi bazën e garës midis të barabartëve për të gjithë ata që i plotësojnë kriteret për të kandiduar, e jo sipas trashëgimisë fisnore ose mbretërore. Ndërsa sistemi demokratik liberal mundohet t'i ngritë strukturat e saj mbi parimet zgjedhore të themeluara nga vetë përvoja e njeriut, duke mos i përfillur prioritet që dalin nga parimet themelore të këshillave hyjnore. Islami, në vetë përmbajtjen e vet, është sistem qytetar, u jep të drejtën secilit individ për të besuar dhe zhvilluar fenë dhe jetën e tij, ashtu sikur ai e sheh të dobishme për të. Ai që ka besuar Islamin, atij i bëhet obligim t'i ndjekë parimet dhe ligjet Islame. Aty, ku brenda një shteti myslimanët janë shumicë, vendi udhëhiqet mbi parimet e përgjithshme të ligjit islamik. Kjo nuk do të thotë se komunitetet e tjera fetare apo ideologjitë e ndryshme janë të privuar nga drejta e tyre për të gjykuar dhe jetuar sipas ligjeve të tyre.¹³

Kolonializmi së bashku me bashkëpunëtorët e tij është munduar me të gjitha forcat (nuk ka kursyer asgjë) që të vërtetojnë një ide: "Islami nuk ka lidhje me politikën dhe nuk ka kurrfarë lidhjeje me shtetin." Mirëpo, në anën tjetër, u angazhuan thirrësit reformatore në krye të të cilëve ishte Hasan el Benna u angazhua maksimalisht që t'i mësojë muslimanët me idenë e

¹¹ SHELTUT, Mahmud, "Islami fe dhe jurisprudencë", Dar el Shuruk, Bot.I dhjetë, Kajro 2002, f.29

¹² 197 HUBERMAS, Jurgen, "Ah Evropë" Asdreni, Shkup 2011, f.97

¹³ Dr. Muhamed F. JUSUFI, Pranverë Arabe apo Zgjim Islam dhe qasja e saj në mediet e shkruara shqiptare, Instituti për Hulumtime strategjike Ballkanike, Prishtinë, 2017, f.140

"Gjithëpërfshirjes së Islamit", apo, thënë ndryshe, që t'i kthejë në atë që ishte vendosur dhe vërtetuar gjatë 13 shekujve, që do të thotë para paraqitjes së kolonializmit dhe invazionit mendor në vendet e tyre, e ajo është: Islami e përfshin vertikalisht jetën në tërësi me legjislacionin dhe udhëzimin e tij, prej lindjes së njeriut e derisa Allahu t'i sjellë vdekjen atij, madje edhe para se të lindë dhe pasi që të vdesë, sepse në të ka dispozita ligjore që kanë të bëjnë me foshnjën para lindjes dhe dispozita që kanë të bëjnë me njeriun pas vdekjes së tij; dhe horizontalisht, ashtu që Islami, e orienton muslimanin në jetën e tij.¹⁴

Çka kanë thënë orientalistet në këtë kontekst. Mendimet e tyre i kanë sqaruar me fjali të qarta, të prera, për shkak se këta reformatorë nuk mund të pretendojnë se janë me lidhje më të besueshme se ata (orientalistët) me kohën e tanishme, e as me fuqi, më të madhe në përdorimin e metodave moderne të hulumtimit dhe shfrytëzimin e metodave shkencore.

Më poshtë po paraqesim një pjesë të thënieve të tyre:

1. Dr. V. Fitzgeraldi thotë: "Islami s'është vetëm fe (religjion), por, po ashtu, është edhe sistem politik. Përkundër faktit se në kohën e fundit janë paraqitur disa persona prej muslimanëve, që e cilësojnë veten se janë "moderniste", orvaten që të ndajnë ndërmjet dy anëve, por s'ka dyshim se konstruksioni i mendimit islam në tërësi është ndërtuar në bazë të asaj që të dyja anët janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën, nuk mundet që të veçohet njëra anë prej tjetrës".

2. Prof. C. A. Nallino thotë: "Muhammedi ka themeluar fe (religjion) dhe shtet në të njëjtën kohë, dhe kufijtë e të dyve ishin të përshtatshëm gjatë gjithë jetës së tij."

3. Dr. Schacht thotë: "Edhe pse Islami nënkupton më shumë se fe, ai, po ashtu, paraqet mendime ligjore dhe politike. E thënë me një fjalë: Ai është sistem i plotë prej kulturës, përfshin së bashku fenë dhe shtetin."

4. Prof. R. Strothmanni thotë: "Islami është dukuri fetare-politike, për arsye se themeluesi i tij ishte Pejgamber, ishte politikan i urtë dhe burrështeti."

5. Prof. D.B. Macdonaldi thotë: "Këtu pra, në Medine është formuar Shteti i parë Islam dhe janë vënë parimet themelore të Ligjit Islam."

¹⁴ Jusuf Kardavi, Doktrina e shtetit në Islam, Furkan, Shkup, 2012, f.29

6. Sër, T. Arnoldi thotë: "Pejgamberi ishte njëkohësisht kryetar i fesë dhe kryetar i shtetit."

7. Prof. Gibb thotë: "Atëherë është bërë e qartë se Islami nuk ishte vetëm besim fetar dhe personal, por ai e bëri të domosdoshëm formimin e shoqërisë së pavarur, i cili ka mënyrën e vet në pushtet dhe që ka ligjet dhe sistemet e posaçme për të."¹⁵

Që gjysma e fundit e shekullit të 20-të do të shihte një ringjallje të fesë dhe diskursit fetar në shoqëri, në politikë dhe rrjedhimisht edhe në ligj nuk ishte një kthesë e papritur në histori, duke pasur parasysh strategjinë e Luftës së Ftohtë për të vënë në veprim një kundërmasë efektive kundër komunizmit. Sidoqoftë, çfarë mund të kishte qenë më pak e pritshme ishte se ky zhvillim do të vazhdonte në një shkallë të madhe edhe pas rënies së Murit të Berlinit. Si fenomen, kthimi i fesë ka qenë i pranishëm në një numër vendesh anembanë globit, pavarësisht nga veshmbathja e veçantë fetare.

Megjithatë, roli i ri i fesë nuk është një fenomen teologjik, por në vend të kësaj është pjesë e një agjende më të gjerë politike. Inkorporimi i fesë në politikë dhe ligj nuk bëhet nga dashuria për fenë, por si një terren legjitim për të kryer një politikë të caktuar. Mund të themi, siç thonë disa, se feja e politizuar nuk është fe e vërtetë dhe ajo që shohim që ndodh në emër të fesë nuk është asgjë më shumë se diskursi fetar që përdoret për të fshehur zgjedhjet politike që në fakt janë në kundërshtim me fenë "e vërtetë".¹⁶

Shteti Islam është shtet i të drejtave dhe i lirive, me besim dhe përkushtim, e jo me propagandë dhe fjalë. S'ka dyshim se e drejta e jetës, e drejta e pronës, e drejta e furnizimit jetësor, e drejta e sigurisë mbi fenë, nderin, pasurinë dhe prejardhjen, konsiderohen në teorinë e Legjislacionit Islam prej pesë ose gjashtë "gjërave të domosdoshmen, për të cilat All-llahu zbriti Sheriatin me qëllim të ruajtjes së tyre, dhe nuk i lejohet askujt që t'i shpërfillë ato. Ligjdhënësi i Lartësuar ka obliguar sanksione të rrepta dhe dënime me vdekje, me qëllim të mbrojtjes së tyre prej agresionit të mundshëm mbi ta.

Obligimi i shtetit Islam është të punojë në mënyrë që secilit individ, që jeton në hijen e tij, t'ia realizojë këto dy qëllime themelore prej qëllimeve të jetës së tij (furnizimin dhe sigurinë),

¹⁵ Jusuf Kardavi, *Doktrina e shtetit në Islam*, Furkan, Shkup, 2012, f.36

¹⁶ A.A. An-Na'im, *Islam and the Secular State: Negotiating the Future of Sharia*, Cambridge MA, and London: Harvard University Press 2008

derisa t'u mundësohet njerëzve kur të furnizohen dhe të sigurohen, t'i kushtohen adhurimit të Zotit të tyre.

Islami, ashtu siç luftoi idenë mbi dallimin racor, me të njëjtin intensitet kundërshtoi edhe nacionalizmin duke marrë parasysh faktin që të gjithë njerëzit janë bijtë e Ademit dhe rrjedhin nga të njëjtët prindër. Nuk ekziston ndonjë racë që dallohet me ndonjë cilësi që i bën ata të jenë të veçantë ndaj të tjerëve.

Iluzioni i disa njerëzve që mendojnë se njerëzimin e përbëjnë raca të ndryshme e që disa nga këto raca janë me të denja për t'i sunduar të tjerët, ndërkohe që fati i këtyre të fundit është që të mbeten të nënshtruar. Padyshim që kjo bindje e gabuar shkaktoi padrejtësi të mëdha dhe rrëmujë në mesin e njerëzimit.

Fanatizmi patriotik dhe nacional motivon çdo komb të ketë aspirata për të sunduar tjetrin, nxit ata që të krenohen dhe të glorifikojnë kombin që i përkasin me arsyetimin se gjoja bëhet fjalë për një komb që është më i ngritur dhe më i lavdishëm se kombet e tjerë. Në të kaluarën bindjet e këtilla bënë që toka të mbulohej me gjak nga luftërat e shumta që ishin pasojë e aspiratave të udhëheqësve shtetërorë që dëshironin të sundonin popujt dhe territoret e ndonjë shteti tjetër.

Islami gjithmonë e luftoi nacionalizmin ekstrem në të gjithë format e tij si dhe pretendimet territoriale dhe politikat ekspansioniste duke u përpjekur të vendosë rend ku do të sundojë drejtësia dhe ku do të mbretërojë harmonia në mesin e njerëzve pavarësisht vendndodhjes së tyre.¹⁷

¹⁷ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.34

Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam

Kufijtë janë një e dhënë konstante për të drejtën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Vetëm se ndonjëherë, kjo e dhënë na pengon t'i shohim fushat e ndikimit afatgjatë të ndryshimeve në ekuacionin e forcës. Kufijtë në Lindjen e Mesme të kujtojnë një mur të thurur jashtëzakonisht keq.¹⁸ Ekuilibri fuqive dinamike që vërehet në Lindjen e Mesme në periudhën pas Luftës së Ftohtë, ka dhënë rezultate që e shpalosin para syve këtë krizë dhe, disa herë, e acarojnë këtë. Sot, Lindja e Mesme as është brenda një strukture polarizimi të orientuar nga kushtet e Luftës së Ftohtë, as strukturimi i saj kufitar i cili reflekton përpjesëtimin kolonial, premtion një të ardhme të qëndrueshme. Ky strukturim i paekuilibruar dhe i paqëndrueshëm e shtyn çdo aktor që t'i formojë nga e para politikat e tij afatshkurtra sipas animitet për të ngritur fusha ndikimi afatgjata dhe të qëndrueshme. Dhe kjo ka bërë që vendin e politikave të ndikueshmërisë zonale ta zënë politikat që mbështeten mbi, bazën e ndikueshmërisë të proceseve të gjata diplomatike.¹⁹

Sot bota arabe jeton një periudhë pavendosmërie dhe pafuqie e cila reflekton gjurmët e kësaj lufte të brendshme. Periudha e pafuqisë e konfirmuar edhe nga Eduard Said, ka bërë që kjo botë e cila nuk mundet ta përdorë energjinë e brendshme të saj në mënyrë efektive dhe produktive, përpigjet të mbetet në këmbë me anë të themelit të legjitimitetit që ia sigurojnë kërcënimet e jashtme. Për këtë shkak, nacionalizmi arab përjeton një ndryshim cilësie me rëndësi. Ky nacionalizëm i kontrolluar i mbështetur edhe nga aktorët sistemorë jashtëzonale, me ShBA në krye, me qëllim për ta vazhduar stabilitetin në Lindjen e Mesme dhe për t'i mbajtur nën kontroll lëvizjet opozitare pasive që mund ta kërcënojnë këtë stabilitet, është duke formuar fusha tensionimi potencial në zonë.²⁰ Elita politike e botës arabe ku sundojnë mbretëritë ku vazhdon kultura fisnore dhe diktaturat autokratike, për t'i mbajtur në këmbë këto struktura, përdor mjetet e legjitimitetit mbështetur në faktorë të jashtëm.

Ekzistenca e Izraelit përbën vazhdimisht një element kërcërimi në zonë dhe bart synime ekspansioniste ndaj vendeve tjera. Arabët të cilët e kanë humbur çdo luftë që kanë zhvilluar gjer tani me Izraelin, janë bindur për domosdoshmërinë e lidërshipeve politike dhe ushtarake të

¹⁸ Ahmet Davutogllu, Thellësia strategjike, Pozita ndërkombëtare e Turqisë, Logos – A, Shkup, 2010, f.389

¹⁹ Po aty, f.435

²⁰ Po aty, f.437

fuqishme përballë këtij kërcënimi. Kjo e bën gjithashtu të nevojshme bashkëveprimin reciprok të vendeve të rajonit si dhe formimin e organizimeve të përbashkëta me anë të së cilave vendet me popullatë muslimane do të mund të mbrohen dhe të ndërtojnë strategji të përbashkët.

Për sa i përket sistemit ndërkombëtar, vendet dhe popullsitë arabe, si dhe të gjitha vendet dhe popullsitë muslimane, e kanë humbur në masë të madhe besimin se ky sistem zotëron një mekanizëm objektiv dhe që vepron me drejtësi. Faktet si moszbatimi i vendimeve të OKB-së lidhur me Palestinën, qëndrimi i heshtur ndaj pushtimit izraelit të Libanit të Jugut, qëndrimi prej spektatori për një kohë të gjatë ndaj iniciativave për gjenocid në Bosnjë kanë sjellë me vete përdorimin e mosbesimit të këtyre vendeve për vazhdimin e strukturimeve të lidërshiptit autokratik.²¹

Procesi i ndryshimit ku shoqëria lihet jashtë qarku, jep botës arabe pamje stabiliteti politik formal, domethënë, vetëm sa për dukje. Çështja më e rëndësishme sot në politikën e shoqërive arabe është se ndryshimi në drejtimin nuk shihet si një proces që e ka legjitimitetin në popull. Ky është edhe shkak i themelor që formimi i lidërshiptit politik në botën arabe ka mbetur i mbërthyer dhe i shtrënguar mes mbretërve të përcaktuara nga larja e hesapeve brenda-familjare dhe diktaturave të përcaktuara nga larja e hesapeve brenda-ushtarake. Përfundimi pa sukses i provave të pjesëmarrjes politike në vende si Algjeria, Tunizia, Jordania, etj., vë në shesh, nga njëra anë, problemet e kulturës së politikës së brendshme dhe, nga ana tjetër, marrëdhënien e vartësisë midis elementëve të jashtëm dhe strukturës politike të brendshme.²²

Sipas pikëpamjeve islame bashkëpunimi ndërmjet bashkësive njerëzore paraqet rregull të përgjithshëm i cili i inkurajon njerëzit për bashkëpunim në punë të mbarë, ndërsa ndalon nga bashkëpunimi në punë të këqija dhe në armiqësi. Ndiqma reciproke paraqet gurthemel në funksionimin e bashkësisë muslimane në botë. Tekstet e shumta fetare islame udhëzojnë që njerëzit të ndihmohen dhe bashkëpunojnë mes vete si në nivel rajonal ashtu edhe në atë ndërkombëtar.²³

Islami apelon për tolerancë, e cila nuk shpie poshtërim dhe përrulje. Kjo nënkupton që Islami tenton të ndërtojë marrëdhënie ku mbizotëron toleranca mes individëve dhe bashkësive

²¹ Ahmet Davutogllu, Thellësia strategjike, Pozita ndërkombëtare e Turqisë, Logos – A, Shkup, 2010, f.442

²² Po aty, f.444

²³ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.37

njerëzore, mirëpo duke mos iu nënshtruar së keqes dhe duke mos u lejuar qëllimkëqijve të keqpërdorin këtë thirrje. Nëse imponohet nevoja për t'u ndëshkuar kriminelet, atëherë ajo duhet të jetë në proporcion me krimin e kryer.²⁴

Toleranca dhe falja e armikut ishin prioritet i politikës islame në marrëdhëniet me njëritjetrit në përgjithësi e në veçanti në marrëdhëniet me jo-muslimanët. Kjo ishte politika që zbatohej në kohë paqeje, ndërkohë që në kohë lufte zbatohej politikë që synonte përfitimin e zemrave të armikut, sepse i ngadhënjyeri ka nevojë për kurimin e plagëve e jo pezmatimin e tyre. Islami nuk konsideron liri të mirëfilltë atë që është dominuar nga dëshirat, por konsideron liri të mirëfilltë atë formë lirie që është nën kontrollin dhe pushtetin e mendjes së kulluar dhe besimit të sinqertë.

Për sa i përket lirisë së besimit, Islami respekton plotësisht të drejtën e lirisë së besimit dhe ndalon përdorimin e dhunës për të detyruar dikë të përqafojë islam. Islami e ndalon rreptësisht imponimin e bindjeve fetare duke e konsideruar këtë akt shkelje dhe dhunim të drejtave fetare, ngase lëndon shpirtin, mendjen dhe zemrën. Liria e besimit nuk nënkupton vetëm ndalesën për të imponuar bindjet fetare, por, njëkohësisht, kërkon që këto bindje të formohen si pasojë e meditimit përmes mendjes së kulluar larg ndikimit të dëshirave apo imitimit të verbër. Sipas mësimave islame, bindjet fetare përbëhen nga këto parime:

Të menduarit e çliruar nga ekstremizmi kombëtar, tradicional, si dhe nga dëshirat dhe epshet. Këtu duhet potencuar fakti që shpeshherë ndodh që feja të keqpërdoret dhe të manipulohet me të për qëllime kombëtare apo për të realizuar ambiciet personale.

Ndalimi nga konvertimi i dhunshëm në një fe të caktuar si dhe përqafimi i saj duke qenë të joshur nga pasuria, pozita apo autoriteti. Nuk është besimtar i sinqertë ai që pranon fenë islame duke qenë i motivuar nga këta faktorë.²⁵ Islami gjithmonë u ka garantuar lirinë e besimit të gjitha bashkësive që jetuan nën juridiksionin islam si dhe popujve me të cilët muslimanët kishin firmosur traktate duke u lejuar atyre kryerjen e ritualeve fetare. Juristët muslimanë miratuan norma dhe parime juridike të nxjerra nga Kur'ani dhe tradita profetike, siç është parimi i njohur të urdhëruar të respektojmë bindjet e njerëzve në atë që ata besojnë. Liria e besimit iu garantua të

²⁴ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.40

²⁵ Po aty, f.46

gjithë atyre që jetuan nën hijen e Islamit, ashtu që asnjë jo-muslimani nuk iu mohua e drejta e të praktikuarit lirshëm e fesë së tij.

Kur jemi tek normat morale, shikuar nga prizmi islam, marrëdhëniet mes individëve apo bashkësive duhet të ndërtohen në bazë të këtyre parimeve, të cilat duhet respektuar si në kohë paqeje po ashtu edhe në kohë lufte. Këto principe duhet të jenë përcaktuese në marrëdhëniet ndër-njerëzore pavarësisht përkatësisë së tyre racore, vendit ku jetojnë apo pozitës së tyre në shoqëri. Ajo që konsiderohet e keqe në mesin e individëve në një shoqëri, duhet konsideruar si e tillë edhe në marrëdhëniet mes popujve dhe shteteve. Ajo që është e dëmshme për atdheun tënd është e tillë edhe për ndonjë shtet tjetër, andaj ajo duhet shmangur pavarësisht nëse bëhet fjalë për popull apo shtet me të cilin jemi në marrëdhënie paqeje apo lufte. Çdo qenie njerëzore gëzon të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të denjë dhe njerëzore ashtu siç u ka hije të gjitha qenieve që mbajnë epitimin njeri. Sjellja dinjitoze ndaj njëri-tjetrit është parim që Islami e ka konfirmuar dhe urdhëron që ajo të gjejë zbatim mbi të gjithë në mënyrë të barabartë.

Nëse çdo fe ka tiparet e saj me të cilat karakterizohet, atëherë tipari i Islamit është drejtësia me të cilin ai veçohet. Drejtësia është përcaktuesi më i denjë i marrëdhënieve ndërmjet njerëzve si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë lufte. Ajo është peshorja më e saktë, e cila garanton të drejtat e njerëzve dhe është mbrojtës i tyre. Njëkohësisht paraqet elementin kryesor që mundëson mirëqenien njerëzore.²⁶ Një ndër format më të dalluara të drejtësisë është trajtimi i armikut në mënyrë të njëjtë. Kjo nënkupton që liderit të muslimanëve i lejohet që marrëdhëniet me shtetet apo popujt e tjerë t'i rregullojë në bazë të parimit të reciprocitetit. Për shembull, nëse sulmohen, këta kanë të drejtë t'i kundërvihen agresionit. Mirëpo, në qoftë se armiku anon kah paqja, në këtë rast muslimanëve u ndalohet të luftojnë kundër tyre. Po ashtu, në qoftë se kundërshtari shkel marrëveshjet e arritura mes tyre dhe muslimanëve, atëherë edhe këtyre të fundit u lejohet të veprojnë po në të njëjtën mënyrë duke shpallur të pavlefshme marrëveshjen e mëparshme. Mirëpo, nuk duhet harruar se gjatë zbatimit të parimit të reciprocitetit në raportet me të tjerët, muslimanët obligohen të respektojnë normat morale dhe ato fisnike. Muslimanët luftojnë për të mbrojtur vlerat njerëzore dhe për këtë arsye atyre nuk u takon që të jenë pjesëmarrës në krime të dhunshme dhe akte çnjerëzore.

²⁶ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.48-57

Atëherë kur armiku shfaq armiqësi duke sulmuar muslimanët, këtyre u lejohej përdorimi i forcës kundër tij po në të njëjtën masë dhe po me aq intensitet sa konsiderohet e domosdoshme për t'u mbrojtur dhe për të zbrapsur agresorin, por duke mos i tejkaluar kufijtë e mbrojtjes. Luftëtarit musliman nuk i lejohej vrasja e atyre që nuk marrin pjesë në luftë (civilëve) qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu, ndalohej edhe vrasja e fëmijëve dhe të moshuarve, bujqve apo të ngjashmit me ata për punën dhe prodhimtarinë e të cilëve njerëzit kanë nevojë. Këto kategori njerëzish nuk duhen vrarë meqë nuk janë pjesëmarrës në luftë. Ajo që lejohej është vetëm vrasja e luftëtarëve në fushëbetejë.

Islami jo vetëm që tenton të vendosë baraspeshë mes shteteve të forta dhe atyre të dobëta, por, njëkohësisht, përkrah fuqishëm edhe popujt e shtypur nga tirania dhe despotizmi. Profeti Muharnned u dërgonte mbretërve dhe perandorëve porosi duke ftuar ata të përqafojnë Islamin, ndërkohë që kërkonte prej tyre të sillen drejt me qytetarët e tyre duke mundësuar që porosia islame të arrijë deri tek veshët e tyre. Pastaj, pasi që t'u bëhet e qartë se çka është Islami, atyre t'u garantohet liria ashtu që ata që dëshirojnë lirshëm të përqafojnë këtë fe. Duke i shërbyer kësaj maksime, Islami çdoherë ka qenë mbrojtës i të drejtave dhe lirive të popujve të shtypur, e veçanërisht mbrojtës i lirisë së besimit. Luftërat që u zhvilluan në emër të Islamit nuk kishin qëllim tjetër pos mbrojtjes së këtyre lirive.²⁷

Këto ishin rregullat që ka vendosur Islami në bazë të së cilave sendërtonte marrëdhëniet ndërkombëtare. Rregullat e këtilla kërkojnë zbatim si në kohë paqeje ashtu edhe në kohë lufte dhe se janë në pajtueshmëri të plotë me standardet e sjelljes së drejtë. Për shembull, sjellja që merr në konsideratë normat morale pranohet si standard nga të gjitha shoqëritë. Nisur nga ky qëndrim, është më se e logjikshme të konstatojmë se çdo normë që vërtetohet si e dobishme dhe pozitive nga anëtarët e shoqërisë e njëjta duhet të konsiderohet si e tillë edhe nga subjektet ndërkombëtare në raportet e tyre ndërshtetërore. Nuk është e drejtë të thuhet se e drejta ndërkombëtare që rregullon marrëdhëniet mes kombeve dallon nga ligjet nacionale që përcaktojnë raportet mes qytetarëve brenda shtetit. E vërteta është se bëhet fjalë për rend dhe sistem sepse burojnë nga burime të njëjta fetare. Për shembull, ligjet nacionale rregullojnë raportet mes individëve duke paraparë sanksionim për autorin e veprës penale, është më se e drejtë të themi që e njëjta praktikë të gjejë zbatim edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare duke

²⁷ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.63-74

ndëshkuar ato subjekte ndërkombëtare, gjegjësisht shtetet agresore që bëjnë krime ndaj njerëzimit.²⁸

Parimi themelor mbi të cilin sendërtohen marrëdhëniet ndërkombëtare është paqja. Islami në të gjitha rastet apelon për paqe, ndërkohë luftën e konsideron si diçka shumë negative. Islami ndalon luftën kundër popujve paqedashës, madje edhe nëse këta janë jo-muslimanë.

Islami njëmend konfirmon se paqja përbën sendin themelor mbi të cilin sendërtohen marrëdhëniet ndërshtetërore dhe se muslimanëve u ndalohet të ndërhyjnë në, punët e brendshme të shtetit tjetër përveç kur është në pyetje mbrojtja e lirive të njerëzve. Këtu bëhet fjalë për situata kur popujt e shtypur kërkojnë ndihmë nga autoritetet e shtetit musliman, si, për shembull, kur mbi ta ushtrohet dhunë nga shkaku i përkatësisë së tyre fetare. Në këto raste Islami lejon ndërhyrjen duke synuar me këtë ndalimin nga ushtrimi i dhunës si dhe për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e besimit. Përndryshe në të gjitha rastet e tjera duhet të respektohet sovraniteti shtetëror i çdo subjekti ndërkombëtar dhe e drejta e tyre për të mbrojtur territorin e tyre në rast sulmi pavarësisht nivelit të tyre qytetërues apo shkallës së zhvillimit.

Udhëheqësit e perandorive që kishin frikë se me përhapjen e Islamit do të rrezikohej pozita e tyre, ose mbreterit që frikoheshin se me përhapjen e dritës së Islamit do të përfundonte autoriteti i tyre politik, angazhoheshin me çdo kusht të pengonin përhapjen e kësaj drite (Islamit) tek populli i tyre. Për këtë qëllim numri i armiqve të muslimanëve sa vinte e shtoej. Muslimanët ishin të detyruar t'i përshtateshin realitetit të hidhur që nënkuptonte nevojën që muslimanët të jenë vazhdimisht syçelë dhe të jenë në gjendje gatishmërie për të luftuar kundër armikut. Ata në asnjë mënyrë nuk guxonin të lejojnë që armiqet e tyre të përgatiten për luftë kundër tyre dhe të ushtrojnë dhunë mbi ta, ndërsa ata të rrinë duarkryq duke pritur që të sulmohen në shtëpitë e tyre.

Me qëllim të shmangies nga derdhja e gjakut (luftës), muslimanët të gjitha fiseve dhe popujve që i rrethonin u ofronin tri alternative:

- te bëjnë marrëveshje për armëpushim apo, thëne ndryshe te nënshkruajnë traktat paqeje që ndalon nga armiqësia.

²⁸ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.78

- të konvertohen në muslimanë dhe në këtë mënyrë mes tyre të krijohen lidhje vëllazërore.
- nëse refuzojnë marrëveshjen, e cila do të përcaktonte obligimet dhe detyrimet e palëve nënshkruese, dhe nëse refuzojnë konvertimin në Islam, nuk ngelet asnjë alternative tjetër pos luftës, pasi që refuzimi i dy opsioneve të para shpalos qëllimet e tyre armiqësore.²⁹

Sistemi ndërkombëtar në kohën që jetojmë karakterizohet me organizatat ndërkombëtare që obligojnë shtetet anëtare të respektojnë konventat ndërkombëtare si dhe detyrimet që burojnë prej tyre. Në këtë kontekst, shtetet muslimane anëtare të këtyre organizmave duhet t'i respektojnë këto marrëveshje ndërkombëtare dhe të përmbushin premtimin e dhënë.³⁰

Burimet e së drejtës ndërkombëtare janë praktika e shteteve në marrëdhëniet mes tyre si dhe marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare. Legjitimiteti dhe fuqia e së drejtës ndërkombëtare islame buron nga parimet e përgjithshme që rregullojnë raportet ndër-njerëzore që i kemi cekur më herët, siç është respektimi i marrëveshjeve dhe zbatimi premtimit të dhënë. Andaj, marrëveshjet e drejta dhe transparente dukshëm kanë kontribuar në formimin e kësaj dege të ligjit islam.

Si rrjedhojë, çdo dispozitë islame që trajton çështjen mbi paqen ndërtohet mbi tre parime themelore:

- 1) Të vepruarit me drejtësi në raportet mes muslimanëve dhe të tjerëve, avancimi i marrëdhënieve të mira, angazhimi për t'u njohur dhe bashkëpunuar mes njerëzve. Këto urdhëresa kur'anore kërkojnë zbatim në jetën praktike. Muslimanët që janë në lidhje fqinjësore me jo-muslimanët duhet t'i sendërtojnë marrëdhëniet mes tyre mbi parimin e miqësisë së sinqertë.
- 2) Ndalimi nga të qenët armiqësorë ndaj të tjerëve, ngase Islami ndalon agresionin në të gjitha format e tij. Nëse muslimanët paraqesin forcë, këta duhet të garantojnë dhe respektojnë të drejtat e popujve që janë të dobët.

²⁹ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.93

³⁰ Po aty, f.103

- 3) Mbrojtja e lirive të komuniteteve jo-muslimane, veçanërisht lirinë e besimit, sepse, ashtu siç përmendëm edhe më lart, Islami ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike. Islami këtyre u garanton lirin e përdorimit të simboleve të tyre fetare. Madje, disa shkolla të mendimit juridik konsiderojnë të ligjshme konsumimin e gjerave, të cilat, sipas bindjeve të tyre fetare janë të lejuara, edhe pse Islami ndalon konsumin e tyre sepse i konsideron të dëmshme.³¹

Islami ndalon edhe përdorimin e mjeteve apo armëve që shkaktojnë dëme të mëdha siç është armatimi bërthamor. Përdorimi i këtyre armëve ndalohet për këto arsye:

- ato shkaktojnë shkatërrim masiv.
- Përdorimi i tyre paraqet armiqësi ndaj popullatës me të cilin jemi në luftë, ndërsa Islami urdhëron të luftohet vetëm kundër pushtet-mbajtësve agresor e jo edhe qytetarëve të pafajshëm.
- përdorimi i tyre, mes tjerash, shkakton edhe vrasjen e grave dhe fëmijëve, ndërsa vrasja e tyre është e ndaluar

Duke marrë parasysh këto argumente konstatojmë që muslimanëve u ndalohet përdorimi i këtyre armeve përpos nëse armiku përdor armë të këtilla. Në këtë rast përdorimi i tyre lejohet, mirëpo duke pasur kujdes që ato të përdoren vetëm në mënyre të kufizuar dhe pa e tepruar. Nisur nga ky qëndrim, muslimani duhet t'i ofrojë mbrojtje secilit që e kërkon këtë, madje edhe nëse kjo kërkesë parashtrohet në fushëbetejë me qëllim që t'i jepet përparësi ndalimit të luftës. Marrëveshja për të vënë dikë nën mbrojtje vlen si për individët ashtu edhe për grupet. Nën mbrojtjen e tij muslimani mund të vendosë edhe personat që janë ngujuar në kështjella. Bartësit e këtij statusi nuk konsiderohen robër lufte, por "komunitet i mbrojtur", status që u garanton të drejta dhe detyrime sikurse muslimanëve. Kjo marrëveshje hyn në fuqi vetëm pasi që autoritetet muslimane të kenë konfirmuar ligjshmërinë e tyre, me ç'rast autoritetet përkatëse nuk duhet t'ia mohojnë askujt këtë të drejtë përpos nëse bëhet fjalë për persona të infiltruar në mesin e muslimanëve me qëllim për t'i spiunuar ata.³²

³¹ Muhammed Ebu Zehra, Marrëdhëniet ndërkombëtare në Islam, Furkan, Shkup, 2013, f.167

³² Po aty, f.223

Liritë që përjetojnë njerëzit në kohën tonë, të cilat konsiderojnë prej shpikjeve të revolucioneve moderne në Perëndim, si Revolucioni Francez dhe të tjerë, Islami u ka paraprirë me sqarimin dhe thirrjen në to, dhe Shteti Islam veprimi për përkujdesjen e tyre dhe nxjerrjen e tyre prej sferës së teorisë në sferën e zbatimit.

Liria fetare, siç është shprehur dijetari ynë i nderuar, El-Gazali, All-llahu e mëshiroftë, është zbulim islam, për arsye se nuk është e njohur nga ndonjë prej feve të tjera që t'i kenë kushtuar kujdes vendosjes së lirisë fetare për pjesëtarët e feve të ndryshme. Pastaj, Islami refuzoi dhunën në fe, me çfarëdolloj forme dhe e konsideroi besimin (imanin) se ai vjen nëpërmjet mënyrës së bindjes dhe zgjedhjes së lirë.

Islami ka konfirmuar lirinë fetare për ata që jetojnë në kuadër të Shtetit Islam nga jomuslimanët, siç janë: çifutët, të krishterët dhe zjarrputistët, duke i toleruar ata në lirinë e besimit (fesë), lirinë e adhurimit dhe lirinë e të gjykuarit në Sheriatin e tyre në atë çka i urdhëron me të. Madje, i toleroi ata që të hanë prej ushqimeve që në Islam janë të ndaluara dhe të fëlliqura, siç është mish i derrit, derisa ata besojnë në lejimin e ngrënies së tij. Ky është kulmi i tolerancës, në të cilin s'ka arritur asnjë fe tjetër.

Liria e fjalës dhe e mendimit është e mbrojtur, madje çështja në teorinë e Islamit dhe shtetit të tij është më shumë prej qenies së tij liri. Ai në teorinë e Islamit konsiderohet prej çështjeve të domosdoshme dhe obligative, jo prej çështjeve të të drejtave dhe lirive. Prandaj, është obligim Për njeriun, kur të shohë një të keqe të dukshme, të ndalojë prej saj, sa të jetë e mundur. Ai nuk është i lirë që të hesht ose të hasë, sepse ai që hesht nga e vërteta është sikurse ai që flet të pavërtetën, dhe ai që hesht nga e vërteta është djall memec! Po ashtu, kur të shoh ndonjë të mirë të humbur, atëherë ai obligohet të urdhërojë në të dhe kjo nuk konsiderohet prej çështjeve të së drejtës, që ai ta vërtetojë dhe ta lejë atë.

Kjo hyn në sferën e obligueshmërisë së njohur islame, dhe ajo është: Urdhëresa për të mirë dhe ndalesa nga e keqja. Liria e diturisë dhe e mendimit është e garantuar në teorinë e Islamit dhe shtetin e tij, madje të menduarit është obligueshmëri islame, ndërsa kërkimi (nxënia) i diturisë është i domosdoshëm (farz) për çdo musliman dhe muslimane.

E kur të bëhen dituria dhe mendimi dy obligime të domosdoshme, atëherë çështja bëhet më shumë se thjeshtë një e drejtë që i kushtohet kujdes apo liri që mbrohet. Prandaj, ai është

obligim i patjetërsueshëm dhe i domosdoshëm, dhe muslimani obligohet që të ndihmohet mbi të dhe të qortohet apo të dënohet nëse bën lëshime (tregohet i pakujdesshëm) në të.

Shteti Islam është shtet që është pasuruar (ka pranuar në gjirin e vet) me shkolla të ndryshme shkencore dhe mendore gjatë historisë, posaçërisht në shekujt e lulëzimit civilizues.³³

S'ka dyshim se Islami ka rregullat, dispozitat dhe udhëzimet e tij: në politikën e arsimit, politikën e informimit, politikën e legjislacionit, politikën e pushtetit, politikën e pasurisë, politikën e paqes, politikën e luftës dhe çdo gjë që ka ndikim në jetë, duke mos pranuar të jetë zero në aritmetikë, apo të jetë shërbëtor i filozofive ose ideologjive të tjera, madje nuk pranon, përpos që ai të jetë zotëriu, udhëheqësi, i pasuari dhe i shërbyeri.

Po cila është esenca e demokracisë? Esenca e demokracisë larg përkufizimeve dhe terminologjive akademike është që njerëzit të zgjedhin se kush do udhëheqë në politikën e çështjes së tyre, në mënyrë që mos t'u imponohet atyre ndonjë pushtetar që e urrejnë, apo ndonjë sistem që e urrejnë, por ata të posedojnë të drejtën e llogarisë së pushtetarit kur ai gabon dhe të drejtën e shkarkimit dhe të ndërrimit të tij kur të devijojë, mos t'i drejtojë njerëzit edhe përkundër mospranimi të tyre drejt orientimeve ose programeve ekonomike, shoqërore, kulturore apo politike që ata nuk i njohin dhe nuk pajtohen me to. E nëse dikush prej tyre i kundërshton ato, dënimi i tij është dëbimi dhe shtypja, madje torturimi dhe vrasja.

Kjo është esenca e demokracisë së vërtetë, për të cilën njerëzimi ka gjetur forma dhe mënyra praktike, si zgjedhjet dhe referendumi i përgjithshëm, pluralizmi i partive politike, e drejta e pakicës në kundërshtim, liria e shtypit, pavarësia e gjykatës, etj.³⁴

Përhapja e Islamit në një hapësirë mjaft të gjerë gjeografike gjatë shekullit të parë të lindjes së tij, është një manifestim i qartë i karakterit të tij universal. Po ashtu, të pranuarit e Islamit nga grupe njerëzish apo pjesëtarë me vlera të ndryshme sociale, kulturore, racore, gjuhësore dhe me besime të ndryshme tradicionale, gjithsesi është dëshmi se Islami e pranon llojllojshmërinë dhe, po ashtu, synon harmoninë sociale dhe bashkëjetesën e qëndrueshme dhe të qetë ndërmjet popujve dhe grupeve të ndryshme etnike. Thënë politikisht, Islami dallohet me

³³ Jusuf Kardavi, Doktrina e shtetit në Islam, Furkan, Shkup, 2012, f.74

³⁴ Po aty, 2012, f. 212

konceptin e formimit të shtetit nacional pa marrë parasysh kufijtë territorial si përkufizim i lëvizjeve dhe të vendqëndrimit të njerëzve.³⁵

Si religjion universal, Islami e zgjeron Porosinë e tij në mbarë njerëzimin. Gjithë kjo bëhet me qëllim që të pranohet dituria dhe të pranohen gjuhët, ndërsa të kuptuarit dhe komunikimi me kulturat e popujve dhe grupeve të ndryshëm të jetë sa më efikas. Në mendimin Islam dhe në principet juridike (islame) në mënyrë permanente nxitet koekzistenca kulturore, me qëllim që të thellohen kontaktet njerëzore dhe njerëzit të njihen ndërmjet vete. Kështu, pra, dalluese e arsimimit islam qëndron në atë se Islami orvatet, të formojë njeri të pajisur me kuptueshmëri universale që mundëson adaptim dhe tolerancë ndaj njerëzve të tjerë pa asnjë dozë të diskriminimit në aspekt të racës, ngjyrës së lëkurës, kulturës, ose të prejardhjes. Megjithatë, Islami nuk e përkufizon veten vetëm në çështjet religjioze, por kufijtë e tij zgjerohen duke synuar inkluadrimin e të gjitha aktiviteteve njerëzore, dëshirat, veçoritë socio-kulturore dhe shpresat.

Bashkëjetesa njerëzore mund të përmirësohet po që se pranohet shumëllojshmëria e grupeve dhe popujve. Për dallim nga globalizimi, sistemi universal dhe Islami i pranojnë kulturat e njerëzve të tjerë dhe ofrojnë përkrahje në promovimin e trashëgimisë së tyre kulturore dhe tradicionale. Historia e qytetërimeve të kaluara, veçanërisht ajo e Islamit, treguan se pranë dallimeve të tyre gjeografike, linguistike dhe kulturore njerëzit ndërmjet vete jetuan në harmoni. Në vështrimet e tij ndaj qytetërimit Islam në Spanjë, Xhejms Burk ka shkruar: "Shoqëria e pasur dhe sharmante kishte qëndrim tolerant ndaj religjioneve të tjera. Mijëra hebrenj dhe të krishterë jetuan në paqe dhe harmoni me zotërinjtë e tyre muslimanë. Pasuria materiale e vendit përdorej për përmirësimin e kualitetit të jetesës. Atje ku ishte Islami, aty paraqitej edhe etja për dituri, si dhe për zbatimin e saj."³⁶

Në një llojshmëri të këtillë qëndron uniteti i zbatuar nga ana e principeve universale islamike. Mekanizmat përkrahës të sistemit të këtillë universal përfshijnë principet e etikës islame dhe harmonisë sociale, me qëllim që të mbrohen identitetet njerëzore dhe, natyrisht, bashkëjetesa e qetë. Principet bazë të këtilla, siç janë: drejtësia, liria, barazia dhe toleranca janë zbatuar në të gjitha komponentët e shoqërisë, madje pranë të gjithave atyre dallimeve grupore. Me pranimin e llojllojshmërisë kulturore, modeli universal islamik formon një forcë refuzuese të

³⁵ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.71

³⁶ Po aty, f.72

hegjemonizmit kulturor që është duke u përhapur me globalizimin. Modernizimi i shoqërive muslimane nuk ka nevojë për zbatimin e modeleve perëndimore që të përsosë zhvillimin dhe përparimin e tij, veçanërisht pa vlerësimin e implikimeve që mund të dalin nga ndryshimet e tyre. Shekuj më parë, njerëzit i ndanin vlerat e përbashkëta nën mbrojtjen e Islamit, që solli deri në themelimin e shoqërive multikulturore dhe përparimtare. Kjo është mundësuar përmes zbatimit të principit të universalitetit, i udhëhequr nga detyrimet etike dhe morale. Ismail Faruku ka thënë: "Me siguri, ndikimi më i madh i Islamit është që nuk ka zot tjetër përveç me supozimin e tij të nënkuptuar se çdo njeri i është porositur religjioni natyror nga dhe se ai është universalizmi i tij. Të gjithë njerëzit, sipas këtij këndvështrimi, janë mëkëmbës në Tokë. Të gjithë janë subjekte nën detyrimet morale dhe të gjithë janë objekt të veprimtarisë së tyre morale reciproke. Evidente është se kanosja më e madhe ndaj këtij universalizmi, me këtë edhe ndaj Islamit, është partikularizmi, qëndrim ky i cili pohon se njerëzit duhet t'i vlerësojnë dallimet personale nga pjesa tjetër e popullatës më shumë se karakteristikat e përbashkëta."³⁷

Bota muslimane përfshin një hapësirë të gjerë gjeografike, e cila shtrihet prej Azisë Juglindore e deri në Marok dhe në Afrikën Veriore. Në këto vende lëviz shuma e resurseve të ripërtërira dhe të atyre të paripërtërira që zbulohen. Në më shumë se dy shekuj të dominimit kolonialist, një sasi e madhe e resurseve u eksploatua me qëllim që të përmbushen kërkesat e jashtme. Orientimi i ekonomisë së këtyre shteteve drejt këmbimeve ndërkombëtare formoi një shthurje, varësi ekonomike, degradim ekologjik dhe varfërim të resurseve të paripërtërira. Në këtë proces, përhapja e këtyre ekonomive u zgjerua deri në shkallë që zhvillimi ekonomik filloi të lëviz njësoj si qarkullimet rrethore në tregun global. Sot, numri më i madh i këtyre shteteve jo vetëm që kanë mungesë të strukturës së ekonomisë së ndryshme, por ato, po ashtu, nuk posedojnë as mjetet themelore për rivitalizimin e procesit të zhvillimit. Degët e ekonomisë të mbështetura në dituri janë tepër të rafinuara që këtyre shteteve t'ua mundësojnë dobinë konkrete nga globalizimi. Gjendja në botën muslimane është përshkruar në mënyrë mjaft precize nga ana e ish-Kryeministrit të Malajzisë, dr. Mahatir Muhamedit, i cili ka thënë: "Nuk ekziston asnjë shtet islamik që do të mund të klasifikohet si i zhvilluar. Ekzistojnë shtete që janë mjaft të pasura me resurse natyrore. Mirëpo, pothuajse të gjitha kanë ngecur në dituritë moderne, në aftësitë teknologjike dhe në sferat tjera për një qeveri efektive. Në fakt, një numër i konsiderueshëm i

³⁷ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.74

tyre gjendet në kufirin e anarkisë së vërtetë. Kurrfarë kriteresh të këtyre shteteve nuk mund të konsiderohen si të zhvilluara. Varfëria, kufizimet dhe destabilizimet janë bërë karakteristika të përbashkëta në botën muslimane, edhe atë deri në atë masë, saqë është bërë, pothuajse, pasojë sikur del nga mësimi islam. Prandaj, nuk është për t'u habitur se bota bashkëkohore e ndërlidh Islamin me prapambeturin."³⁸

Parë nga brenda, bota muslimane - si në aspektin gjeografik, ashtu edhe në atë strategjik - është në një pozitë mjaft të volitshme. Shtetet mjaft lehtë mund të lidhen përmes linjave ajrore, rrugëve detare dhe kështu të mundësohet transporti, lëvizja e njerëzve, e kapitalit dhe e të mirave materiale. Në këtë mënyrë mund t'i ofrohet rajonit një përparësi komparative në prodhim dhe në konsumim. Duke bërë orvatje që resurset në shtetet muslimane të shfrytëzohen në mënyrë efektive, do të mundësohet që varësia e tyre nga pjesa tjetër e botës të jetë më e vogël. Një tendencë e tillë mund të zgjerohet me zhvillimin e teknologjive dhe prodhimeve vendase, gjë që mund të ketë efekt pozitiv në prodhim dhe mund t'i kënaqë nevojat vendase. Potenciali për rritjen e prodhimeve bujqësore dhe mirëmbajtjen e sigurisë afatgjate për ushqim në botën muslimane është mjaft premtues (pra në favor të botës muslimane), duke pasur parasysh faktin se resurset janë dislokuar në sferat më efikase dhe në ato shkencore. Teknikat moderne bujqësore bëhen gjithnjë e më të dobishme në tejkalimin e kushteve të ndryshme klimatike dhe ato mund të adoptohen për prodhim dhe promovim. Bota muslimane sot mbështetet në rezervat ushqimore të huaja për më shumë se një të tretat e nevojave të veta në ushqim. Pritet që varësia të thellohet edhe më tej, pikërisht për faktin kur dihet se nataliteti është në rritje; pastaj, ekziston mungesë e iniciativave, teknologji joadekuate nëpër ferma, nivel i ulët i hulumtimeve në bujqësi, si dhe financim i dobët. Në botën muslimane veçanërisht në kohën e krizave nuk ekziston ndonjë mekanizëm i drejtë për distribuimin e resurseve agrikuturore me qëllim që të lehtësohen mangësitë dhe të kontrollohen çmimet. Agrikultura përfshin sektorin e rëndësishëm dhe një pjesë të ekonomisë në disa shtete muslimane, jo vetëm në kuptimin e numrit të madh të popullsisë, por, po ashtu, edhe në kuptimin e përmbushjes së resurseve për prodhim lokal, siç është goma, pambuku, elbi, hurmat, etj.

Përparësia tjetër e botës muslimane qëndron edhe në atë se fuqia e punës së saj është bazë për zhvillim të ardhshëm. Numri i madh i banorëve është faktor elementar për tregun në zhvillim

³⁸ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.79

dhe për çmim të ulët të punës. Disa rajone në botën muslimane akoma duhet të zhvillohen, ndërsa prezenca e fuqisë së lirë të punës mund të shfrytëzohet për zmadhimin e prodhimit për në tregun lokal dhe për në atë global. Së bashku me përdorimin e teknologjive komunikuese dhe hulumtimet shkencore, globalizmi mund ta përshpejtojë procesin e zhvillimit po që se koordinimi i përpjekjeve bëhet në mënyrë efikase dhe të njëjtat harmonizohen me programet dhe politikat e shëndosha. Me qëllim që të gjendet kanali i vërtetë për dislokimin e investimeve - për shkak të zmadhimit të prodhimeve dhe të maksimizimit të mjeteve në sektorë të ndryshëm është e domosdoshme të ndërmerren studime dhe hulumtime të hollësishme. Përkaj kësaj, edhe menaxhimi dhe përdorimi i drejtë resurseve do ta minimizonte ndikimin e lëvizjeve globale të ekonomive në shtetet muslimane. Si do që të jetë, stabiliteti ekonomik zakonisht është i ndërlidhur me stabilitetin e sistemit social dhe politik. Prandaj, do të ishte vendimtare të zbatohen politikat aktive me qëllim që të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm ekonomik. Për shkak të kolapsit ekonomik, cili ndodhi në vitin 1997 në Azinë Juglindore, gjendja ekonomike e më shumë se 100 milionë njerëzve në Indonezi kishte rënë nën vijën e varfërisë. Në tre deceniet e fundit të ekonomive globale, hartuesit e politikave kanë shikuar vetëm anën progresive të globalizimit, por asnjëherë nuk i kushtuan kujdes negativiteteve apo mangësive.³⁹

Pothuajse të gjithë anëtarët e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik (OBI), ku bëjnë pjesë mbi 50 shtete, janë numëruar ndër shtetet e zhvilluara. Ndër to, ato e ndajnë mangësinë e përbashkët të elementit bazë për zhvillim të shoqërisë ku ekziston standardi i përcaktuar minimal. Pranë potencialit të tyre tregtar si dhe të potencialit të resurseve, mundësive financiare dhe prospekteve - shtetet muslimane janë ndër më të varftrat në botë. Në vitin 2000 të ardhurat mesatare të një muslimani kanë qenë rreth 1.015 dollarë ose 5 herë më pak se mesatarja botërore dhe 27 herë më pak se të ardhurat mesatare në shtetet e zhvilluara. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2000 të ardhurat botërore janë rritur për 45 %, ndërsa në shtetet muslimane u rritën sa gjysma e kësaj shifre.

Përkundër faktit se muslimanët paraqesin 1 miliardë e 360 milionë banorë ose 22.5 % të popullatës së tërësishme botërore, në vitin 2000 pjesëmarrja e tyre në të ardhurat botërore ishte 4.4 %. Sipas të dhënave të OKB-së, thuhet se në vitin 1998, 860 milion ose 64 % nga banorët e përgjithshëm muslimanë kanë fituar të ardhura mesatare prej 755 dollarëve, me përjashtim të një

³⁹ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.81

numri të vogël të shteteve që posedojnë naftë. Numri më i madh i muslimanëve jeton në kushte të cilat janë nën nivelin për jetë normale.⁴⁰

Gjatë historisë, muslimanët dhanë kontribut të rëndësishëm në të gjitha sferat e shkencës. Kjo ndodhi gjatë qytetërimit të tyre. Charles Moraze tregon: "Ishte në Islam, në periudhën ndërmjet rënies anti-kulturore të Romës dhe zgjimit të Evropës katedrale, atëherë kur astronomia dhe shkencat e tjera vazhdimisht lulëzonin përmes inovacioneve të rëndësishme. Në këtë mënyrë, Islami u bë përparimtar që nga fillimi i zgjerimit të tij, ishte krenar me atë që u bë qendër e hulumtimeve shkencore dhe të teknologjisë gjeniale. Në Mesjetë, në raste kur ishin të nevojshëm inxhinierë efikas për ndërtimin e urave të larta, ftoheshin ekspertë arabë që të realizojnë projekte të tilla. Pas disfatës ushtarake në shek. XV, Islami e humbi primatin në këto sfera dhe ra në një shkallë të konzervatizmit. Mbeti në atë gradë që të ruajë identitetin e tij origjinal, përderisa Evropa gëzonte dobitë nga gjurmët e ndikimit intelektual dhe rezultatet e ndryshimit të cilat i inkudroi Reformacioni dhe teknologjitë zejtare që u zhvilluan në qendrat e banuara." Pjesa tjetër e botës i tejkaloi muslimanët përmes kapitalizmit, si në aspektin shkencor, ashtu edhe në atë të ndryshimeve teknologjike, me qëllim të zgjerimit të efikasitetit të prodhimit dhe konkurrencës në tregti. Në këtë kohë të globalizimit, si shkak i dekadencës së tyre në dy shekujt e kaluar dhe të joadekuatësisë së poliseve të tanishme nacionale për shkencë dhe teknologji në shtete të ndryshme, muslimanët u marginalizuan. Duke vërejtur pasqyrën e gjendjes së Botës Islame në sferën shkencore, Charles Issawi ofron një shembull dhe thotë: "Atëherë kur gjatë Luftës së Dytë Botërore italianët u larguan nga Libia, ekzistonin vetëm shtetas të Libisë me diplomë universitare."⁴¹ Detyra e adresimit të sfidave globale dhe të zgjerimit të integriteteve është e rëndë dhe mund të kërkojë shqyrtim të serishëm të gjithë infrastrukturës institucionale në shoqëritë islame në nivelet lokale, rajonale dhe në ato internacionale. Në vendet islame harxhimet publike në sferën e arsimit janë mjaft të ulëta, ndërsa institucionet private kontribuojnë me shumë vështirësi në përparim dhe në hulumtime shkencore. Shtetet islame harxhojnë në hulumtim dhe zhvillim rreth 0.5 % të shumës së përgjithshme të prodhimeve të tyre nacionale, gjë që është shumë larg mesatares së 5 %-shit në shtetet e zhvilluara.

⁴⁰ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.82

⁴¹ Po aty, f.118

Polisa shkencore në këto shtete duhet të jetë pjesa integrale e planit nacional për zhvillim social dhe ekonomik. Fituesi i çmimit Nobël, Abdus-Selami, theksoi nevojën për themelimin e një Fondacioni Islamik me qëllim që të zhvillohen studime dhe hulumtime në sferat siç janë stërvitjet në nivele të larta, të fituarit e kualiteteve hulumtuese, kontaktet me bashkësinë shkencore botërore, hulumtimet e sponsorizuara dhe popullarizimi i shkencës. Vizioni i tij qëndron në atë se një fondacion i tillë do t'i mundësojë Botës Islame të përparojë shkaqet e zhvillimit shkencor dhe do t'u ndihmojë muslimanëve të konkurrojnë si të barabartë me pjesën tjetër të botës. Lidhur me këtë, ai tha: "Asnjë shtet islamik nuk posedon konkurrencë të lartë shkencore dhe teknologjike. Ndërsa ekonomia botërore fitoi gjithnjë e më shumë në planin global, zbrazëti ndërmjet shteteve të industrializuara dhe shoqërive islame është duke u thelluar (zgjeruar) edhe më tej, ndërsa përparimi shkencor dhe teknologjik mbetet i kufizuar vetëm për shtetet e pasura të Veriut. Vendet islamike do të mundnin të bëjnë depërtime vendimtare me formimin e një Fondacioni Shkencor. Fondacioni do të sponsorizohej nga vendet islame dhe do të operonte brenda tyre. Ky Fondacion do të ishte jopolitik, i pastër shkencërisht dhe do të udhëhiqej nga njerëz eminent të shkencës dhe teknologjisë nga Bota Islame."

Është me rëndësi të përmendet se në Islam shkenca konsiderohet si detyrim religjioz, të cilën çdo musliman dhe muslimane duhet medoemos ta arrijnë. Me regjimin e globalizimit, kërkesa për dituri bëhet më urgjente për shkak të konkurrencës globale. Teknologjia informative dhe tregjet financiare kërkojnë dituri shumë më të thella nga ato që posedon sot numri më i madh i shteteve në zhvillim, numëruar këtu edhe shtetet islamike.⁴²

Ekziston një numër i madh i sfidave të brendshme dhe të jashtme me të cilat ballafaqohen sot muslimanët. Ato janë:

- 1) SFIDA POLITIKE
- 2) SFIDA INTELEKTUALE
- 3) SFIDA EKONOMIKE
- 4) SFIDA GLOBALE
- 5) SFIDA MORALE

⁴² Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.120

Për nga aspekti politik, duhet të bëhen orvatje serioze në dobi të të gjitha qeverive që t'i rikonstruktujnë institucionet e tyre si dhe t'i demokratizojnë proceset politike me qëllim që të lejojnë pjesëmarrje publike, t'iu japin njerëzve të drejtë që të deklarohen edhe më qartë për përparimin e interesave nacionale dhe t'i detyrojnë udhëheqësit e tyre të bartin përgjegjësi për veprat e tyre. Liritë dhe të drejtat individuale duhet medoemos të jenë të mbrojtura nga të gjitha format e padrejtësive dhe diskriminimit, po qe se shteti e ka të domosdoshme të themelojë legjislaturë për qeverisje. Fuqia islame nuk qëndron në krijimin e dinastive, por ai është një besim i cili duhet medoemos të zbatohet përmes sinqeritetit, përgjegjësisë dhe sjelljes etike e morale: Ndër fondamentet më të rëndësishme të Islamit janë uniteti dhe vëllazëria. Organizata e Bashkëpunimit Islamik (OBI)⁴³ është themeluar me qëllim që të veprojë në përforcimin e unitetit ndërmjet shteteve anëtare, por muslimanët sot janë të ndarë më shumë se asnjëherë më parë.

Për nga aspekti intelektual, në kulminacionin e qytetërimit, muslimanët ua kaluan të tjerëve në të gjitha fushat e diturive, përfshirë këtu shkencat natyrore, artin, astronominë, matematikën dhe mjekësinë. Sot ata kanë humbur gjithçka si rezultat i refuzimit të diturive liberale dhe të shkencave eksperimentale, në favor të mësimit religjioz konservativ për të ruajtur identitetin e muslimanit. Koncepti i diturisë dhe i derivateve të saj në Kur'anin Fisnik përmendet 880 herë, që do të thotë se detyrë e çdo muslimani dhe muslimaneje është që të arrijnë dituri. Po ashtu, tradita islame i këshillon muslimanët që të udhëtojnë edhe në vende të largëta, siç është Kina, vetëm e vetëm që të marrin mësim dhe të shfrytëzojnë përvojën në përparimin e gjendjes së muslimanëve. Mund të thuhet se pranë nxitjeve të ekonomisë globale - vendet islame sot ndajnë shumë pak nga resurset e tyre me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve intelektuale të shoqërisë së tyre. Numri më i madh i analfabetëve ekziston tek muslimanët, edhe atë më shumë se në cilindo grup tjetër në botë. Pikëllim është kur vërejmë se një numër i madh i intelektualëve muslimanë iu shërbejnë jomuslimanëve për shkak të mungesës së stimulimeve adekuate, fondacioneve të pamjaftueshme, kapaciteteve joadekuate hulumtuese, mungesës së mundësisë dhe pasojave politike. Siç thotë: fituesi i çmimit Nobël, Nexhib Mahfudh, "Tanimë fuqia e shtetit nuk matet sipas forcës ushtarake, me numrin e banorëve, me pozitën gjeografike ose me resurset por me numrin e shkencëtarëve që posedon, me aftësitë e tyre shpikëse dhe aftësive për të zbuluar, me të arritur dhe zbatuar."

⁴³ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.130

Sfida ekonomike është ndoshta nxitja më e madhe me të cilën ballafaqohen muslimanët nën regjimin e globalizimit. Ekziston nevojë urgjente për politikat e zëshme dhe efektive ekonomike për të arritur rezultate të kënaqshme në prodhim, veçanërisht në rezervat bujqësore dhe në ato ushqimore, e gjithë kjo me qëllim të zvogëlimit të varësisë nga pjesa tjetër e botës. Përmbushja e nevojave vetjake e zmadhon sigurinë nacionale duke e inkurajuar prodhimtarinë vendase. Profesor Attasi konsideron se qëllimi esencial për zhvillim në Islam qëndron në arritjen e kënaqësive përmes balancimit të nevojave materiale dhe të atyre shpirtërore të njeriut. Iniciativat për përparimin e prodhimit lokal duhet të koordinohen ndërmjet shteteve të ndryshme me një përkrahje të fuqishme për hulumtim, stërvitje dhe financim të bizneseve të vogla, si dhe të bujqve. Ekonomia e re, e cila mbështetet në dituri, kërkon teknika të reja dhe konkurrencë po që se dëshirohet përmirësim i prodhimtarisë industriale. Qeveritë duhet të ofrojnë një ambient të shëndoshë ekonomik të përkrahur nga politikat makroekonomike, me qëllim që të lehtësojnë lirinë e tregut dhe të sigurojnë stimulim. Institucionet financiare, përfshirë këtu tregun e parave, berzën dhe tregun kapital, janë esenciale për përparimin e zhvillimit në shoqëritë islamike. Theksimi i faktorëve vendas dhe të rrethinës në zhvillim, po ashtu, janë çështje esenciale për zhvillim të qëndrueshëm.⁴⁴

Teoria e përparësive komparative iu shërben muslimanëve më mirë në tregtitë lokale brenda Botës Islame, se sa me pjesën tjetër të botës. Që të përmirësojnë fuqinë e tyre të qëlluar dhe të arrijnë ndikim në ekonominë globale, muslimanët duhet medoemos të jenë të aftë të ballafaqohen me standardet internacionale dhe të arrijnë përparësi në konkurrencë.

Sfida globale. Ndryshimet jo të largëta që u realizuan në sistemet globale monetare, financiare dhe tregtare, janë udhëhequr nga ana e interesave të disa shteteve (kryesisht anëtarë të grupit G-7). Nuk është mençuri të mendohet se me globalizim nënkuptohet liria e ekonomisë së tregut. Me ekonominë globale manipulohet, me qëllim që t'i, shërbehet ndërmarrjeve multinacionale dhe interesave ekonomike të popujve të fuqishëm. Kontrolli i tyre mbi financat globale, teknologjinë, menaxhmentin, komunikimet, hulumtimet dhe ndaj zhvillimit, janë faktorë vendimtar pas forcës së tyre ekonomike. Shtetet Islame, aktualisht, as në mënyrë e as në atë kolektive, nuk kanë mundësi të ballafaqohen me forcat e reja të lojtarëve global. 75 % të rezervave të naftës së argumentuar botërore dhe të gazit natyror gjenden në vendet islamike,

⁴⁴ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.131-132

mirëpo zëri i tyre dëgjohej mjaft dobët atëherë kur janë në pyetje vendimet që iu dedikohen operacioneve të industrisë. Vështrimi i realizuar i revistës The Economist tregon se energjia është industria më e madhe botërore me shumën e punës globale me më pak se 1.7 në trilion dollarë amerikan në vit. Veç kësaj, këshilli "Energjetik Botëror" llogarit se investimi global i viteve 1990 dhe 2020 do të jetë me shumën e përgjithshme prej 30 trilionë dollarë me çmimet e vitit 1992. Këtu ka nevojë urgjente për themelimin e ndërmarrjeve multinacionale të ngjashme me Kompaninë Maleziane të Naftës "Petronas" dhe institucioneve rajonale si Banka Islame me qëllim të zgjerimit të konkurrencës. Lëvizja e faktorëve, siç janë klasa punëtore, kapitali dhe të mirat materiale, janë komponentë mjaft të rëndësishëm të ekonomisë globale.

Detyrë e muslimanëve është që të punojnë pranë njëri-tjetrit në ndërtimin e shoqërisë së drejtë dhe morale. Sfidat e tanishme me të cilat ballafaqohen muslimanët burojnë nga fakti se fundamentet themelore islame, siç janë drejtësia, liria dhe barazia, nuk vihen në praktikë. Principet e etikës në Islam përbëjnë skeletin e funksionimit të shoqërisë islame, duke përfshirë çdo aspekt të jetës njerëzore. Islami i jep rëndësi të veçantë koncepteve të drejtësisë sociale, të drejtës ekonomike, ndarjes së barabartë të të ardhurave, lirisë së individit, si dhe detyrimeve dhe përgjegjësi të shtetit. Dijetari i famshëm islam, El Gazali, e rezymon Islamin si "synim i barabartë për të fituar, nga njëra anë, dhe synim drejt Zotit, në anën tjetër". Në këtë mënyrë, qëllimi i ndarjes së resurseve në Islam është zmadhimi i mirëqenies së përgjithshme, e jo t'i shërbejë vetëm disa individëve, siç është rasti me globalizimin. Përparimi shekullar i globalizimit është kundërtënkës me mësimet themelore islame, sepse Islami përfshin edhe shikimin karakteristik ndaj botës, renditjen e vlerave, normat kulturore dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme.⁴⁵

Ndërmjet anëtarëve të Kombeve të Bashkuara ekzistojnë më shumë se 50 përfaqësues nga shtetet islamike, të cilët përfaqësojnë pothuajse një të katërtën e banorëve të përgjithshëm të popullatës botërore, por me pak ndikim për të sjellë vendime globale. Britania e Madhe, me më pak se 1 % të popullatës botërore, luan rol të plotë dhe të rëndësishëm në sjelljen e vendimeve dhe ofrimin e formave ndaj shoqërisë globale, kundruall të gjithë muslimanëve së bashku.

⁴⁵ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.134

Njëra nga dobësitë më të mëdha me të cilat sot ballafaqohen muslimanët, është mungesa e vizionit politik për solidaritet. Një numër i madh i muslimanëve besojnë se interesave të tyre më shumë do shërbejë lidhja e fortë me Perëndimin, për shkak të prodhimeve perëndimore, teknologjisë, arsimit, tregut dhe sigurisë. Jostabiliteti politik është aktual në vendet islamike, si dhe rreziku nga konfliktet rajonale dhe qytetare, shpeshherë rezultojnë me atë që disa shtete të ndihen të pasigurta dhe të kërkojnë ndihmë dhe përkrahje nga Perëndimi. Përveç kësaj, presioni i shteteve perëndimore dhe kanosja me bojkot financiar dhe ekonomik i vë në pozitë të palakmueshme disa shtete dhe i detyron t'i forcojnë lidhjet ose të nënshkruajnë marrëveshje rajonale për bashkëpunim me shtetet tjera islamike. Përderisa e themi këtë, në anën tjetër, ekzistojnë 300 milionë muslimanë të cilët jetojnë nën embargo dhe sanksione ekonomike të sponsorizuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, duke shkaktuar në këtë mënyrë vdekjen e mijëra njerëzve të pafajshëm. Me këtë, gjithashtu, ata i bëjnë edhe një grusht të fuqishëm gjendjes socio-ekonomike të atyre shteteve të cilat janë involvuar në këto çështje. Krahas kësaj, ekzistojnë më shumë muslimanë të zhvendosur se sa ndonjë grup tjetër etnik në botë.⁴⁶

Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet muslimanëve në masë të madhe është në dobi të shteteve të Perëndimit, duke i ndarë ato në shtete të vogla, të përçara dhe joefektive. Me fjalë të tjera, "ndryshimet që ndodhin në vendet islamike janë të farkuara përmes termave të interesave, perceptimeve dhe reaksioneve të elitave të brendshme për presion dhe nxitje, të cilat i prodhoi fuqia evropiane, dhe që, përmes dëshirës së tyre, eksploatojnë influencën evropiane në luftë për pushtet në vet shoqëritë e tyre."⁴⁷ Si pasojë e kësaj, nga ata plaçkitet pavarësia nacionale, resurset, mirëqenia, uniteti, trashëgimia kulturore dhe influenza. Sot muslimanët janë të varur nga jomuslimanët më shumë se asnjëherë më parë në aspekt të teknologjisë, diturive, arsimimit, sigurimit, financave, armëve dhe ushqimit.⁴⁸

Ndër të tjera, me qëllim që muslimanët të gëzojnë ndryshime dhe të zgjerojnë pjesëmarrjen në ekonominë globale, ata duhet të synojnë drejt çështjeve vijuese:

- 1) Solidaritetit Islam dhe vetëbesimit kolektiv, që të zvogëlojnë varësinë nga jomuslimanët dhe të mbrojnë interesin ekonomik nga ndikimet e dëmshme të ekonomisë globale.

⁴⁶ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.136

⁴⁷ Ira "Historia e shoqërive islame", (Cambridge University, 1988), fq. 556.

⁴⁸ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.137

- 2) Zhvillimit të resurseve njerëzore, me qëllim të përmirësimit të pjesëmarrjes së njerëzve në procesin e zhvillimit; po ashtu, edhe që të lehtësohet lëvizja e punëtorëve përmes zvogëlimit të restriksionit të lëvizjeve të punëtorëve brenda Botës Islame.
- 3) Të fituarit e identitetit të serishëm civilizues dhe ringjallja e trashëgimisë së të kaluarës. Numri më i madh institucioneve ekzistuese - përfshirë këtu sistemet ligjore, arsimore, sociale, ekonomike dhe ato politike - janë gjurmë të trashëgimisë koloniale, dhe deri më tani janë treguar si të papërgjegjshme për ndryshime në vendet islamike.
- 4) Mëkëmbja e institucioneve islame, siç janë Vakëfi- dhe Zeqati, me qëllim të zbutjes së problemit të varfërisë ndërmjet muslimanëve. Këto institucione, gjithashtu, mund t'i shërbejnë funksionimit të OJQ-ve (Organizatave joqeveritare) transnacionale për të siguruar disa nga shërbimet themelore të shëndetësisë.
- 5) Përparimi i çështjeve të ekonomisë dhe financave islame. Deri më tani, përvoja me format e ndryshme të institucioneve financiare islame është inkurajuese. Është e nevojshme të kujdesemi më shumë drejt themelimit të tregjeve kapitale dhe monetare dhe, gjithashtu, të zhvillohen instrumente për lehtësimin e të ardhurave financiare lokale dhe të atyre globale. Është e nevojshme ndonjë formë e unitetit monetar, me qëllim që qarkullimi të jetë i mbrojtur nga spekulantët.
- 6) Teknologjia e planifikuar përkatëse për zhvillim të qëndrueshëm. Dituria vendase për mjedisin lokal dhe për zhvillim të qëndrueshëm do të shërbejë më mirë me teknikat përkatëse të cilat do të jenë të afta që t'i shfrytëzojnë resurset në mënyrë efikase. Teknologjia e huaj do të mund të shfrytëzohet mjaft, mirëpo nuk do të mund ta zgjidhte qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë.
- 7) Komunikimet dhe informacionet. Muslimanët mund të përfitojnë nga teknologjia ekzistuese në fushën e komunikimit, me qëllim që në mënyrë sa më të fuqishme t'i ndërlidhin kontaktet dhe t'i zgjerojnë informacionet. Ky lloj i komunikimit do t'i tejkalonte barrierat gjeografike dhe ato kulturore ndërmjet muslimanëve.
- 8) Ndërmarrja e përbashkët e aktiviteteve, me qëllim që në mënyrën sa më produktive të shfrytëzohen resurset e tyre financiare, teknike dhe ato njerëzore. Projektet e këtilla do të

prodhojnë lidhje më të mira në të gjitha drejtimet dhe eventualisht do të kishin stimuluar zhvillimin në shtetet islamike. Muslimanët duhet medoemos të angazhohen për lehtësimin e investimit të parave nga nafta në shtetet tjera islame.

- 9) Themelimi i ndërmarrjeve multinacionale, me qëllim që të reklamohen interesat dhe nevojat e muslimanëve, si dhe investimi dhe ndarja e teknologjisë. Bashkëpunimi ndërmjet muslimanëve do të kishte ndihmuar që teknologjitë e reja të zhvillohen dhe të përhapen edhe më shumë. Që të konkurrojnë në tregjet globale, ekonomia e re globale mbështetet në aftësitë e ndërmarrjeve të mëdha.
- 10) Negociatat internacionale. Muslimanët në sferat e bashkëpunimit internacional financiar, ekonomik dhe monetar - duhet medoemos të iniciojnë politikat e unitetit, marrëveshjeve dhe institucioneve, kështu që të jenë të udhëhequr përmes frymës universale dhe të bashkëpunimit me entitetet tjera qytetëruese.
- 11) Implementimi i parimeve islame që të përparohet drejtësia sociale, prona private, barazia ekonomike dhe të drejtat dhe detyrimet individuale.
- 12) Politikat përkatëse për mbajtjen e ndryshimeve Përmes mbrojtjes së ambientit, kontrollimit të natalitetit dhe përmirësimit të kualitetit të vendbanimeve atje ku jetojnë njerëzit, në rajonet urbane dhe në ato rurale.⁴⁹

⁴⁹ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.147

Islami dhe globalizimi

Me inkuadrimin e ideologjisë së orientuar properëndimore, kultura e re globale, e kanalizuar përmes teknologjisë moderne, i anashkalon të gjitha këto karakteristika, pa pranuar veçoritë sociale dhe kulturore të njerëzve të tjerë. Në Islam njeriu është pjesë integruese e një tërësie dhe ky është raporti i tij drejt familjes dhe shoqërisë së tij, që përcakton aktivitetet e tij në shoqëri. Në lidhje me këtë diskutoi edhe Ibn Halduni, i cili thotë se njeriu ekziston me natyrën e tij politike në vete dhe se sistemi social Islam mbështetet në bashkëpunimin me të gjithë anëtarët e shoqërisë. Përndryshe, konkurrenca sociale ndërmjet individit dhe grupit do shkaktojë dëm shoqërisë duke e ndjekur drejt realizimit të dobisë. Sheriati duhet të udhëheqë njeriun drejt të kuptuarit të këtyre qëllimeve përmes përvetësimit të diturisë, besimit të përbashkët, vëllazërisë universale, drejtësisë dhe ko-ekzistencës sociale ndërmjet anëtarëve të tjerë të shoqërisë.

Trendët e reja të globalizimit nuk i pranojnë dallimet njerëzore dhe të gjithë njerëzit i trajtojnë në të njëjtin rrafsh. Homogjenizimi i këtij procesi i anashkalon këto dallime përmes inkuadrimit të ideologjisë së paidiferencuar, që mund të jetë e pavolitshme për ndryshimet sociale në shoqëritë joperëndimore. Islami nuk është ideologji statike e paraparë për të shërbyer për një kohë të caktuar, por ai është religjion (fe) dinamik i paraparë për t'u zbatuar në të gjitha vendet dhe kohët. Për shembull, procesi i pavarur i vlerësimit të çështjeve (ixhtihad), që përfshin elementet e dinamizmit dhe të komentimit të ligjeve islame (Sheriat), ekziston me qëllim që të pasurojë diskursin musliman për planifikimin e jetës së tyre. Në natyrën e tij të tanishme universale, Islami është unik në qasjen e tij drejt promovimit të baraspeshës sociale me mbindërtimin e themeleve të tij të zbuluara me shpalljen e Kurianit dhe të Traditës Profetike (Sunnet).

Pritet që globalizimi të ketë ndikim në veçoritë e këtyre sociale, me atë që do ta radhitë tërë planetin në një proces homogjen të ndihmuar me një rrjet të gjerë të mekanizmave elektronike dhe teknologjike. Atëherë ndikimi do të mund të jetë i vlerësuar si gjithëpërfshirës dhe do të involvojë të gjitha sferat e shoqërisë. Në shoqërinë islame ato janë të ndërlidhura ndërmjet vete, andaj ndikimi i globalizimit nuk mund të jetë i kufizuar. Në këtë mënyrë mund të përcaktohet fitimi nga globalizimi në raport me dobinë e përgjithshme të cilën mund ta ketë shoqëria në kuptim të diturisë, bashkëpunimit, si dhe në kuptim të eliminimit të padrejtësisë,

pabarazisë dhe eksploatimit. Prapëseprapë, këto principe janë të pranuar nga Islami me qëllim që të zbatohen ndaj të gjithë njerëzve në të gjitha vendet: në këtë mënyrë Islami nuk ka nevojë që të globalizohet, sepse e posedon vizionin e tij global. Ashtu siç pohon Ali Mazrui: "Islami është religjioni i parë që e ritualizoi globalizimin. Lutja pesë herë në ditë, të kthyerit e të gjithë besimtarëve muslimanë në një drejtim, do të thotë ritualizim i globalizimit. Koncepti Ummetit anëtarëve të një shoqërie me më shumë se një miliardë besimtarëve është pjesë e globalizimit Mekka, vendqëndrimi i haxhinjve, është një vend i caktuar dhe mjaft i shenjtë të cilin besimtarët muslimanë janë të detyruar ta vizitojnë, madje një herë në jetë, nëse është e mundur për ta. Gjithë kjo paraqet pjesë të globalizimit."⁵⁰

Procesi i ri i globalizimit nuk nënkupton pabarazinë e një numri të madh të traditave kulturore botërore. Me fjalë të tjera, globalizimi mund të përshkruhet si proces social që involvon grupe që janë të varura nga njëra-tjetra pa pranuar identitetet kulturore të njerëzve. Kultura globale homogjene duhet medoemos që të jetë përfaqësuese e të gjitha kulturave, e jo të formojë obsesion për mënyrën perëndimore të jetës. Qytetërimi global duhet të tregojë respekt për të gjitha grupet dhe popujt, si dhe të manifestojë kuptueshmëri ndaj njerëzve të tjerë. Hegjemonia globale shpeshherë i injoron veçoritë e kulturave. Qëllimi përfundimtar i globalizimit është të instalojë të ashtuquajturin fshat global në shoqëri me një kulturë të dominuar me gjuhën e Perëndimit, me mënyrën e jetës dhe me demokraci Pjesa tjetër e njerëzimit, me llojllojshmërinë kulturore dhe identitetin individual, do t'i nënshtrohet marginalizimit ose do të lokalizohen në hapësirat gjeografike ku ata gravitojnë. Së bashku me fuqinë e korporatave multinacionale, institucionet ndërkombëtare dhe direktivat e reja etike globale, globalizimi bëhet qeveri e re botërore që ka një ndikim të madh në lëvizjet tregtare, investime, teknologji, financa dhe në njerëz.⁵¹

Muslimanët duhet të kenë ndërmend se plotësisht e kanë humbur revolucionin industrial. Përderisa ata polemizojnë se a është modernizimi kompatibil me Islamin ose jo, përderisa e akuzojnë njëri-tjetrin në lidhje për çështjet e parëndësishme të shkencës dhe religjionit, përderisa vite me radhë shqyrtojnë se a mund të shfrytëzohet energjia elektrike nëpër xhami ose jo, evropianët ishin preokupuar me zbatimin e diturive të reja në sferat e makinerisë, inxhinierisë, si

⁵⁰ Amër Rubai, Globalizimi dhe bota Islame, Furkan, Shkup, 2009, f.76

⁵¹ Po aty, f.77

dhe me provat për zvogëlimin e nevojave për fuqi pune në njerëz, me ndihmën e makinave (robotëve). Ata i stërvitën dhe i aftësuan punëtorët e tyre për punë nëpër fabrika, zhvilluan teknikat për prodhim masiv, në mënyrë konstante e përmirësuan kualitetin e prodhimeve të tyre, i zvogëluan shpenzimet dhe themeluan tregje masive. Gjithashtu, ata e zmadhuan shpejtësinë dhe kapacitetin e transporteve dhe i pushtuan tregjet e huaja. Dhe, gjithashtu, prodhuan armë më të mira, dhe me të i dhanë fund mbretërisë muslimane. Në të vërtetë, revolucioni industrial e shkatërroi mbretërinë muslimane.

Tani duket se sërish do të ngecim, kësaj radhe pas revolucionit informativ, revolucion i cili "do ta zvogëlojë" botën dhe muslimanët do t'i detyrojë që të qëndrojnë së bashku me popujt e ndryshëm, edhe atë jo vetëm me popujt të feve të ndryshme, por edhe me ata popuj që posedojnë vlera të reja morale, gjë që për muslimanët plotësisht janë të papranuara. Në të kaluarën kemi mundur që të izolohejmë dhe jemi orvatur që ta praktikojmë fenë dhe vlerat tona të kursyera nga ndikimet ndotëse nga të tjerët. Tanimë, një gjë e atillë nuk është e mundur.⁵² Globalizimi nuk do të thotë detyrimisht edhe botë pa kufij. Kufijtë edhe më tej mund të mbeten dhe duhet të respektohen. Përmes kufijve mund të përcaktojmë se çfarë mund të kalohet e çka jo. Natyrisht, nuk do të kemi kontroll të plotë. Informatat e të gjitha formave mundet që pa përkufizime t'i kalojnë kufijtë falë teknologjisë bashkëkohore, por mund ta zhvillojmë softuerin, madje edhe harduerin i cili mund të mbajë jashtë kufijve tonë disa nga fëlliqësitat të cilat mund të arrijnë përmes informatave.⁵³

Për fat të keq, ekzistojnë mjaft muslimanë tek ne dhe në mbarë botën të cilët jo vetëm që asgjë nuk bëjnë për shpëtimin e tyre, por edhe në mënyrë aktive përmes kundërshtimeve të ashpra dhe të dhunshme orvaten për t'i penguar muslimanët tjerë për të ndërmarrë masa mbrojtëse. Çdo herë kur ndonjë nga shtetet muslimane orvatet për të ndërmarrë masa pozitive me qëllim që ta arrijë zhvillimin e pjesës tjetër të botës dhe të pengojë që të mos mbetet nën dominimin e të tjerëve, atëherë paraqiten grupe fanatikësh muslimanë të cilët do të bëjnë gjithçka të mundshëm vetëm që muslimanët t'i lënë të prapambetur dhe të rrezikuar, e gjithë kjo në emër të Islamit. Në të vërtetë ata muslimanë të cilët dëshirojnë që ne edhe më tej të mbetemi të

⁵² Mahatir Muhamed, Globalizimi dhe realitetet e reja, Furkan, Shkup, 2010, f.54

⁵³ Po aty, f.57

prapambetur janë tradhtarë të Islamit dhe të muslimanëve.⁵⁴ Me vetëdije apo pa vetëdije, ata veprojnë në dobi të armiqve të Islamit.

Pra, nëse ne, shumica e muslimanëve nuk dëshirojmë që të na gëlltit globalizimi, atëherë medoemos duhet të mësojmë se si të bashkëveprojmë me të. Gjëja e parë të cilën ne duhet ta bëjmë është të mësuarit e çdo sferë të teknologjive informative, sferë që është aq ngushtë e ndërlidhur me globalizimin.

Ne gjithashtu i jemi nënshtruar edhe dobësimit të religjionit dhe sistemit tonë të vlerave. Mund të paramendojmë se do të mund të izolohejmë si një ishull i vetmuar, por ajo është një shpresë e rrejtshme. Madje edhe nëse jemi të aftë t'i ruajmë kufijtë tanë, ne nuk do të mundemi ta pengojmë komunikimin përmes valëve që ato të mos depërtojnë në shoqërinë tonë.⁵⁵

Tanimë, demokracia nuk është sundimi i shumicës. Dhe, me të vërtetë në më shumë raste, zgjedhjet ku garohet për përkrahjen e shumicës janë bërë plotësisht të pakuptimta. Sepse, qeverisë e cila zgjidhet nga populli, në vend i lidhen duart dhe ajo bëhet e pafuqishme. Dëshira e shumicës - e asaj shumice që kryesisht qëndron heshtur injorohet, ndërsa qeveritë luftojnë për t'i kënaqur dëshirat e një grupi të vogël aktivistësh.

Tani ajo pakicë është bërë e dhunshme, ndërsa qeveritë e zgjedhura në mënyrë ligjore bien falë aktiviteteve ilegale të bandave të rrugëve. Gjatë kësaj kohe vendi destabilizohet, i humbet aftësia për t'u zhvilluar, si dhe për më shumë shtete në zhvillim, me këtë humbet edhe liria e tyre. Njerëzit vuajnë, ligji dhe rregullat shkatërrohen, konfliktet etnike dhe religjioze eskalojnë, ndërsa mijëra njerëz mbyten. Qeverisja e turmës bëhet më demokratike se qeverisja e shumicës. Demokracia keqpërdoret deri në shkallën kur gjithçka është e lejuar në emër të demokracisë. Premtimi për jetë të mirë nuk realizohet. Në vend të kësaj njerëzit vuajnë më tepër se kurrë më parë, më tepër se kur posedonin pushtetin autoritar - gjithçka për shkak të demokracisë. Do të vijë koha kur demokracia do të orientohet rrugës së socializmit dhe komunizmit. Kjo nuk bëhet për atë që demokracia është e shëmtuar. Edhe më tej ky është sistemi (deri më tani, sistem laik) më i mirë i qeverisjes. Mirëpo, demokracia aq tepër keqpërdoret sa që nuk është e aftë të vihet për mirëqenien as të shumicës, e as të pakicës.

⁵⁴ Mahatir Muhamed, Globalizimi dhe realitetet e reja, Furkan, Shkup, 2010, f.61

⁵⁵ Po aty, f.64

Demokracia edhe më tej është në vend të parë. Të bëhesh kritikues i demokracisë do të thotë të jesh heretik dhe t'iu nënshtrohesh sulmeve. Mirëpo, me kohë dëmi do të bëhet aq e qartë dhe aq e madhe, sa që shprehja demokraci do të tingëllojë si fjalë e urryer, ashtu siç diktatura e proletariatit u bë shprehje e urryer, e më pas edhe e papranueshme.

Mirëpo, kjo është e pashmangshme. Demokracia mund të jetë e shpëtuar po qe se nuk ndalemi së vlerësuari si e përsosur, po qe se dobësitë dhe mangësitë e saj pranohen, gjenden ilaçe, ndërsa të tepruarit e saj të vihet nën kontroll.⁵⁶

Nëse gjatë ndërtimit të një shteti nuk ekziston përkujdesje, nëse interesat e popullit dhe shtetit sipas rregullave të ndonjë "ideologjie" vihen në rrezik, nëse vendimet nuk mbështeten në baza reale dhe injorohen argumentet e qarta, atëherë fatkeqësia është e pashmangshme. Për të, natyrisht, duhet fajësuar predikuesit e ideologjisë. Mirëpo, as ne të cilët sjellim vendim për ta pranuar atë ideologji, nuk mund që plotësisht të lirohemi nga fajësia. Sa herë kemi vërejtur se ideologji-të i shkatërrojnë shtetet, e sërish kur ndonjë ideologji e re fillon të predikohet, qëndrojmë të gatshëm për ta pranuar si ndonjë zgjidhje të përsosur dhe të pagabueshme ndaj të gjitha problemeve tona.

Globalizimi meriton shqyrtim serioz dhe ne doemos duhet të definojmë strategji të reaksionit tonë ndaj çështjeve kyçe, që nga globalizimi i biznesit dhe tregtisë, përmes zhvillimit të qëndrueshëm, ekonomisë së mbështetur në profesionalizëm dhe dituri, e deri te çështjet sociale.⁵⁷ Tema e globalizimit bëhet gjithnjë e më e pranishme në vetëdijen dhe përvojën e përditshme të njerëzve në planetin tonë. Dukuritë dhe ndikimet që krijohen gjatë procesit të globalizimit janë të rëndësishme, por edhe të domosdoshme për çdo njeri të së sotmes. Përhapja e feve monoteiste ka paraqitur globalizimin e parë botëror. Po t'i hedhim një vështrim historisë së hershme të Islamit, shtrirjen e tij të shpejtë në gati të gjitha kontinentet, mund të fitojmë një pamje të qartë për këtë proces globalizues. Ka qenë ky një proces i ndërlidhjes dhe depërtimit të popujve të ndryshëm, i traditave, kulturave, zakoneve dhe gjuhëve të ndryshme që janë bashkuar në bashkësinë e tyre. Si çdo fenomen tjetër i përmasave më të mëdha, edhe globalizimi shkakton diskutime të ashpra dhe gjykime të ndryshme të këtij procesi. Përkrahësit e zhvillimit të

⁵⁶ Mahatir Muhamed, Globalizimi dhe realitetet e reja, Furkan, Shkup, 2010, f.72

⁵⁷ Po aty, f.79

pakufizuar industrial dhe ata të cilët duke iu falënderuar globalizimit u pasuruan shpejtë, apo që shpresojnë të pasurohen, e lavdërojnë këtë proces tej mase.⁵⁸

Nga ana tjetër, kundërshtarët e globalizimit e akuzojnë këtë proces për të gjitha të ligat e botës bashkëkohore, për homogjenizimin e formave kulturore në fshatin global në të cilin jetojmë, për shkatërrimin dhe tjetërsimin e identitetit të pakicave të tëra etnike apo popujve, për rritjen e fundamentalizmit religjioz, "terrorizmit" dhe konflikteve etnike, për varfërimin e madh të shumë individëve dhe shteteve sovraane. Vërtet, është fakt i pakontestueshëm se me shpejtësi të madhe shtohet ndarja mes shteteve dhe individëve në të pasur dhe të varfër, ashtu siç shtohet edhe dallimi në fitimet mes njerëzve udhëheqës të kompanive të mëdha dhe punëtorëve të thjeshtë. Në diskutimet rreth globalizimit me lehtësi mund të vërehet fakti se është pak i pranishëm, e mbase edhe krejtësisht mungon diferencimi në vlerësimin e mbarë fenomenit dhe pasojave të tij pozitive e negative.

Caku kryesor i fushatave pushtuese të "atlantizmit" është kontinenti euroaziatik, në të cilin shtrihen mendja dhe zemra e botës, shikuar nën dritën e simbolizmit metageografik. Megjithatë, kufijtë e cekur kontinentalë të konfliktit vlejnë vetëm si orientues teorikë dhe ideologjikë, sepse në realitetin e kësaj arene ato kalojnë tërthorazi nëpër kontinente dhe shtete, nëpër popuj dhe grupe njerëzish.

Ajo që është e dukshme në vlerësimin bashkëkohor të problemeve etnike dhe nacionale dhe të konflikteve në kohën më të re, sidomos në hapësirat tona, është fakti se autorët perëndimorë, sidomos nga vendet që kanë pasur koloni, ose që kanë rol vendimtar sot në skenën botërore, nuk shohin në mënyrë realiste në shkaqet e atyre konflikteve. Shumë shpesh harrohet se kufijtë e shteteve, sidomos atje ku edhe sot vjen deri te probleme të tilla, janë tërhequr në mënyrë arbitrare dhe të padrejtë.⁵⁹

⁵⁸ Ismail Bardhi, Kriza e teologjisë myslimane shqiptare, Logos – A, Shkup, 2009, f.177

⁵⁹ Po aty, f.191

III. ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE ISLAMIKE

Liga Arabe

Liga Arabe është një organizatë politike e cila përpiqet të ndihmojë integrimin e anëtarëve të saj ekonomikisht dhe zgjidhjen e konflikteve që përfshijnë shtetet anëtare pa kërkuar asistencë nga jashtë. Ajo zotëron elemente të një parlamenti përfaqësues të shtetit, ndërkohë që punët e jashtme shpesh trajtohen nën mbikëqyrjen e OKB-së. Ajo paraqet një shoqatë vullnetare e vendeve të pavarura afrikane dhe të Lindjes së Mesme, popujt e të cilëve kryesisht flasin arabisht.

Qëllimet e deklaruara të Lidhjes Arabe janë të forcojnë lidhjet midis shteteve anëtare, të koordinojnë politikat e tyre dhe të promovojnë interesat e tyre të përbashkëta. Qëllimi kryesor i Lidhjes është të "afrojë më shumë marrëdhëniet midis shteteve anëtare dhe të koordinojë bashkëpunimin mes tyre, për të mbrojtur pavarësinë dhe sovranitetin e tyre dhe për të marrë në konsideratë në një mënyrë të përgjithshme çështjet dhe interesat e vendeve arabe".⁶⁰ Përmes institucioneve, të tilla si Organizata Arsimore Arabe, Organizata Kulturore dhe Shkencore (ALECSO) dhe Këshilli Ekonomik dhe Social i Këshillit të Bashkësisë Arabe (CAEU) të Ligës Arabe, Lidhja Arabe lehtëson politikat ekonomike, kulturore, shkencore dhe sociale programe të dizajnuara për të promovuar interesat e botës arabe.⁶¹ Ka shërbyer si një forum për shtetet anëtare për të koordinuar pozicionet e tyre të politikave, për të diskutuar mbi çështje me interes të përbashkët, për të zgjidhur disa mosmarrëveshje arabe dhe për të kufizuar konfliktet siç është kriza e Libanit e vitit 1958. Liga ka shërbyer si një platformë për hartimin dhe përfundimin e shumë dokumenteve të rëndësishme që promovojnë integrimin ekonomik. Një shembull është Karta e Përbashkët Arabe e Veprimit Ekonomik, i cila përshkruan parimet për aktivitetet ekonomike në rajon.

Liga u themelua në Kairo në vitin 1945 nga Egjipti, Iraku, Jordania dhe Jemeni. Vendet që u bashkuan më vonë janë: Algjeria (1962), Bahreini (1971), Komori (1993), Xhibuti (1977),

⁶⁰ "Pact of the League of Arab States, 22 March 1945". *The Avalon Project*. Yale Law School. 1998.

⁶¹ Ashish K. Vaidya, *Globalization* (ABC-CLIO: 2006), f. 525

Kuvajti (1961), Libia (1953), Mauritania (1973), Marok (1958), Omani (1971) , Katari (1971), Somalia (1974), Jemeni Jugor (1967), Sudani (1956), Tunizia (1958) dhe Emiratet e Bashkuara Arabe (1971). Organizata për Çlirimin e Palestinës u pranua në vitin 1976.

Në janar 2003 Eritrea u bashkua me Ligën Arabe si një vëzhgues, ndërsa anëtarësimi i Egjiptit u pezullua në vitin 1979 pasi nënshkroi një traktat paqeje me Izraelin. Selia e organizatës u transferua nga Kajro, Egjipti, në Tunizi.

Në vitin 1987 udhëheqësit arabë vendosën të rinovojnë marrëdhëniet diplomatike me Egjiptin. Egjipti sërish u pranua në ligë më 1989 dhe selia e organizatës u kthye në Kajro.

Libia u pezullua nga Liga Arabe më 22 shkurt 2011. Më 27 gusht 2011, Liga Arabe votoi për të rivendosur anëtarësimin e Libisë duke akredituar një përfaqësues të Këshillit Kombëtar të Tranzicionit, i cili u pranua pjesërisht si qeveri e përkohshme e vendit pas Largimi i Gaddafit nga kryeqyteti i Tripolit.

Më 12 nëntor 2011, Liga miratoi një dekret që do të pezullonte anëtarësimin e Sirisë nëse qeveria nuk arriti të ndalonte dhunën kundër protestuesve civilë deri më 16 nëntor, gjë e cila ndodhi në mes të kryengritjes. Pavarësisht nga kjo, qeveria nuk iu bind kërkesave të Lidhjes.

Më 29 mars të viti 2015, shtetet anëtare të Lidhjes dakordohen të krijojnë forcën e përbashkët ushtarake. Lidhja është takuar në Sharm el-Sheikh mes një krize në Jemen dhe kërcënimit të xhihadistëve të cilët kanë fituar pushtet të madh në Irak, Siri dhe Libi.

Lidhja Arabe do të punojë me përfaqësuesit ushtarakë të anëtarëve të saj për të organizuar atë që është përshkruar si një forcë vullnetare. Analistët thonë se nuk ka gjasa që të gjithë 22 anëtarë të bashkohen me forcën e propozuar.⁶²

Ideja e Lidhjes Arabe u propozua në 1942 nga britanikët, të cilët dëshironin të mbledhin vendet arabe kundër fuqive të Boshtit. Megjithatë, liga nuk u krijua deri në mars të vitit 1945, pak para përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

⁶² http://www.nationsonline.org/oneworld/arab_league.htm

Në atë kohë çështjet që dominonin agjendën e ligës ishte çlirimi i vende arabe që akoma ishin nën sundimin kolonial dhe parandalimi i komunitetit hebre në Palestinë nga krijimi i një shteti hebre.

Trupi më i lartë i ligës është Këshilli, i përbërë nga përfaqësues të shteteve anëtare, zakonisht ministra të jashtëm, përfaqësues të tyre ose delegatë të përhershëm. Çdo shtet anëtar ka një votë, pa marrë parasysh madhësinë e saj. Këshilli mbledhet dy herë në vit, në mars dhe shtator, dhe mund të thërrasë një seancë të posaçme me kërkesë të dy anëtarëve.

Presidenca e Këshillit rrotullohet midis shteteve anëtare dhe sekretari i përgjithshëm emërohet me dy të tretat e shumicës.

Këshilli ka shtatë komisione të posaçme:⁶³

- politik
- ekonomik
- komunikim
- kulturor
- juridik
- social
- shëndetësor

Zakonisht, liga drejtohet nga sekretariati i përgjithshëm i cili udhëhiqet nga një sekretar i përgjithshëm, që është organi administrativ i ligës dhe organi ekzekutiv i këshillit dhe i këshillave të specializuara ministrore.

Efektiviteti i Lidhjes Arabe është penguar ndjeshëm nga ndarjet ndërmjet shteteve anëtare. Për shembull, gjatë Luftës së Ftohtë disa anëtarë ishin të orientuar nga sovjetët ndërsa të tjerët mbështetnin kampin perëndimor. Ka pasur rivalitet mbi udhëheqjen, veçanërisht midis Egjiptit dhe Irakut.

⁶³ Oron, Yitzhak, ed. (1960), Të dhënat e Lindjes së Mesme, 1, Londër: George Weidenfeld dhe Nicholson Limited

Pastaj ka patur armiqësi midis monarkive tradicionale - si Arabia Saudite, Jordania dhe Maroku - dhe republikave të reja, ose shteteve "revolucionare" si Egjipti nën Gamal Abdel Nasser-in, Sirinë Baathiste dhe Irakun dhe Libinë nën Muamar Gadafin.

Liga u testua ashpër gjatë sulmit të udhëhequr nga SHBA kundër Irakut të Saddam Husseinit, me disa anëtarë që mbështetnin sulmin, disa që e kundërshtonin atë dhe të tjerë që qëndronin anash.

Për shkak se vendimet e Ligës Arabe janë të detyrueshme vetëm për anëtarët që kanë votuar për ta, këto ndarje kanë ndikuar në zhbërjen e sferës së "politikës së lartë".

Kështu që Liga nuk arriti të koordinojë politikat e jashtme, të mbrojtjes apo të ekonomisë, duke i bërë dokumentet bazë të ligjeve si Traktati i Mbrojtjes së Përbashkët dhe Bashkëpunimi Ekonomik dhe organet kyçe si Këshilli i Përbashkët i Mbrojtjes plotësisht të paefektshëm.

Kohët e fundit Liga ka treguar një ndjenjë më të madhe qëllimi që nga fillimi i "kryengritjeve arabe" në fillim të vitit 2011. Ajo mbështeti veprimin e OKB-së kundër forcave të Muamar Gadafit në Libi.

Ajo gjithashtu pezulloi Sirinë për shkak të shtypjes së protestave, por misioni i saj monitorues në Damask dështoi për shkak të ndarjeve ndërmjet shteteve anëtare që mbështetnin një rezolutë të OKB kundër qeverisë së Asadit dhe atyre që trembeshin nga "ndërkombëtarizimi" i një çështjeje arabe.

Edhe aty ku anëtarët bien dakord për një qëndrim të përbashkët, siç është mbështetja për palestinezët nën pushtimin izraelit, kjo zakonisht reflektohet vetëm me një lëshim të deklaratës. Ndoshta përjashtimi i vetëm ka qenë bojkoti ekonomik i Izraelit, i cili midis 1948 dhe 1993 ishte pothuajse total.

Megjithatë, Lidhja Arabe ka qenë disi më efektive në nivele më të ulëta, të tilla si formimi i kurrikulave shkollore, ruajtja e dorëshkrimeve dhe përkthimi i terminologjisë moderne teknike. Ajo gjithashtu ka ndihmuar në krijimin e një bashkimi rajonal të telekomunikacioneve.⁶⁴

⁶⁴ <http://www.bbc.com/news/world-middle-east-15747941>

Kryengritjet arabe dhe pasojat pasuese politike, ato të sigurisë dhe humanitare seriozisht sfiduan aftësinë, autoritetin, ligjshmërinë dhe legjitimitetin e Lidhjes Arabe për të ndërhyrë në konfliktet e brendshme në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut.

Interesi i mbijetesës së regjimeve arabe në pushtet dhe shpërndarja rajonale e pushtetit me të vërtetë luajnë një rol të rëndësishëm në politikat e Lidhjes Arabe, por ato nuk janë forcat e vetme. Ka faktorë të tjerë që ndikuan në mënyrë të konsiderueshme edhe në politikat e Lidhjes Arabe, duke përfshirë fuqinë institucionale, normative dhe të njohurive të vetë Lidhjes Arabe, normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, perceptimet dominuese të konfliktit në rrezik, ngritjen e Shtetit Islamik në Irak dhe Levant (ISIL), dhe përfshirje të fuqive të mëdha në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Ndërveprimi i këtyre faktorëve përbën shkakun për politikat e ndryshme të Lidhjes Arabe drejt Sirisë, Libisë, Tunizisë, Egjiptit, Bahreinit dhe Jemenit.

Së pari, Liga Arabe ishte më aktive në politikat e saj drejt Sirisë dhe Libisë, të cilat përjetuan luftëra të mëdha civile me mizoritë masive të të drejtave të njeriut që bien nën kategorinë e "Përgjegjësisë për Mbrojtje". Liga e përjashtoi Sirinë dhe Libinë nga organizata rajonale. Është hera e parë në historinë e saj që Liga përjashton një shtet anëtar për shkelje masive të të drejtave të njeriut. Liga përdorte normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut për të justifikuar politikat e saja drejt Libisë dhe Sirisë. Ndryshe nga indiferenca e saj ndaj vrasjeve masive në të kaluarën (Iraku nën regjimin e presidentit Saddam Hussein, Darfur dhe Siri nën presidentin Hafez el-Assad), Lidhja ndërhyri në mënyra të ndryshme në Siri dhe Libi për të ndaluar vrasjet masive. Liga gjithashtu mbështeti ndërhyrjen ndërkombëtare në Libi. Ky është një ndryshim i madh në politikat e Lidhjes Arabe.

Pavarësisht disa përpjekjeve të ndërmjetësimit, Lidhja dështoi në zgjidhjen e luftës civile siriane për shkak të kompleksitetit të lartë të vetë konfliktit dhe ndërhyrjes së fuqive rajonale dhe të mëdha në Siri. Është e panevojshme të thuhet, Lidhja nuk ka kontroll mbi shumë aktorë vendës, rajonalë dhe ndërkombëtarë të përfshirë në luftën civile siriane. Mungesa e besimit midis Sirisë dhe anëtarëve të tjerë të Lidhjes Arabe (Arabia Saudite dhe Katari në veçanti) gjithashtu përbën dështimin e Lidhjes në ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e krizës siriane. Por edhe një organizatë shumë më e fuqishme ndërkombëtare si Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara nuk arriti të ndalonte luftën siriane.

Së dyti, Liga mbështeti ndërhyrjen ushtarake të Arabisë Saudite në Bahrein dhe Jemen. Por politikat e Lidhjes ndaj Jemenit dhe Bahreinit drejtohen jo vetëm nga fuqia dhe interesat relative të Arabisë Saudite, por edhe nga perceptimet dominuese të këtyre konflikteve të veçanta. Konfliktet në Jemen dhe Bahrein më shumë perceptohen nga regjimet arabe si luftë indirekte e Iranit se sa konflikte të brendshme arabe. Ky perceptim së paku pjesërisht përbën mbështetjen e Lidhjes Arabe për regjimet në Bahrein dhe Jemen. Mbështetja e Lidhjes Arabe për ndërhyrjen ushtarake të Arabisë Saudite në Jemen dhe Bahrein është gjithashtu një ndryshim nga politika tradicionale e Lidhjes për mosndërhyrje. Megjithatë, regjimet qeverisëse në Jemen dhe Bahrein i kërkuan zyrtarisht Arabisë Saudite për ndërhyrje ushtarake.

Së treti, roli i Lidhjes Arabe drejt proceseve të demokratizimit dhe drejtësisë tranzicionale në Tunizi, Egjipt dhe Libi pas rënies së regjimeve të vjetra ishte mosintervencion absolut. Mungesa e fuqisë institucionale, normative dhe njohurive në këto fusha të veçanta përbën mungesën e mbështetjes së Lidhjes për demokratizimin dhe drejtësinë tranzicionale në këto vende. Ky model i sjelljes pasqyron vazhdimësinë dhe jo ndryshimin në politikën e të Drejtave të Njeriut të Lidhjes Arabe dhe demokracisë.⁶⁵

Së fundi, Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se pas disfatës së DEASH-it në Siri dhe Irak, me Ligën Arabe mund të ndihmojnë për procesin e zgjidhjes politike dhe të ristrukturimit në rajon.

Sipas një deklarate nga Kremli, Putin ka publikuar një mesazh me rastin e samitit 29-të të Ligës Arabe që mbahet në Arabinë Saudite.

Duke rikujtuar se takimi po mbahet kur Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut po kalojnë në një periudhë të vështirë, Putin tha se konfliktet e armatosura në Siri, Irak, Libi dhe Jemen vazhdojnë të marrin jetë. Ai theksoi se këto vështirësi kërkojnë përpjekje kolektive të koordinuara të komunitetit ndërkombëtar, ndërsa theksoi se është rritur kërkesa për struktura shumëpalëshe siç është Liga Arabe.

"Ne së bashku mund të ndihmojmë në përshpejtimin e proceseve të zgjidhjeve politike dhe të ristrukturimit në Siri dhe Irak dhe mund të ndihmojmë në zgjidhjen e çështjeve jetësore në

⁶⁵ Dr. Raslan Ibrahim,
Regional Organizations and Internal Conflict: The Arab League and the Arab Spring

kushtet që linden pas disfatës së forcave kryesore të DEASH", tha Putin, duke theksuar se Rusia është gati për bashkëpunim me Ligën Arabe për sigurinë rajonale.

Pasi ka theksuar se duhet të vazhdohet lufta kundër grupeve terroriste nën respektimin e sovranitetit dhe integritetit territorial të shteteve arabe, Putin vijoi me këto fjalë: "Normalizimi në afat të gjatë në Lindjen e Mesme është i pamundur pa zgjidhjen e problemit palestinez. Pozicioni i Rusisë është i pandryshuar. Të gjitha çështjet që lidhen me territoret palestineze, duke përfshirë edhe çështjen e Jerusalemit, duhet të zgjidhen në kuadër të negociatave të drejtpërdrejta Palestinë-Izrael, të bazuara në rregullat universale ligjore, duke përfshirë rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, dhe me përfshirjen e iniciativës paqësore arabe të Ligës Arabe".⁶⁶

Në samitin e fundit të Ligës Arabe është bërë thirrje për hetim ndërkombëtar mbi përdorimin "kriminal" të armëve kimike në Siri dhe është dënuar ndërhyrjen e Iranit në çështjet e brendshme të vendeve arabe.

Samiti i mbajtur në Arabinë Saudite vjen pasi Shtetet e Bashkuara së bashku me Britaninë dhe Francën, kryen sulme në Siri në kundërpërgjigje ndaj sulmit të dyshuar kimik, ku u vranë dhjetëra persona në Siri më 7 prill.

Në këtë samit në deklaratën e publikuar pas mbajtjes së këtij samiti u kërkua një hetim i pavarur ndërkombëtar që do të garantojë se do të zbatohet ligji ndërkombëtar ndaj kujdo që dëshmohet se ka përdorur armë kimike.

Në deklaratë po ashtu kërkohet për më shumë sanksione ndërkombëtare ndaj Iranit dhe bëhet thirrje për tërheqjen e "milicive" të Teheranit nga Siria dhe Jemeni, duke shtuar se Irani është mbështetës i presidentit sirian Bashar al-Assad dhe e ndihmon atë me milicë shiite, që luftojnë përkrah forcave qeveriare. Në Jemen, rebelët Huthi, që Irani i mbështetë, kanë arritur të marrin nën kontroll pjesë të mëdha të shtetit, përfshirë edhe kryeqytetin, Sanaa.

⁶⁶ <http://www.trt.net.tr/shqip/bota/2018/04/15/putin-rusia-dhe-liga-arabe-mund-te-ndihmojne-ne-zgjidhjen-e-problemeve-te-rajonit-951941>, qasur më 16.04.2018

Media shtetërore iraniane, ka cituar zëdhënësin e Ministrisë së Jashtme, Bahram Qasemi të ketë thënë se dënimi që është bërë nga Liga Arabe ka ardhur si rezultat i presionit nga Arabia Saudite, rivalit kryesor të Teheranit.⁶⁷



Figura 1. Samiti i 35 i Ligës Arabe

⁶⁷ <https://www.evropaelire.org/a/29169798.html>

Organizata e Bashkëpunimit Islamik

Me gjithë apelin global, feja e politizuar ka çuar në ndryshime të mëdha në sistemin e brendshëm ligjor kryesisht në vendet me shumicë myslimane. Reaksionet fetare në këto vende u ngritën kundër atyre që shpesh konsideroheshin si qeveri autoritare. Ndikimi i fesë në sistemin e brendshëm ligjor ka luajtur në forma të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme, por një nga ndryshimet më të rëndësishme të ligjit përfaqësohet nga ndryshimet kushtetuese nga sovraniteti popullor në sovranitetin hyjnor si bazë për legjitimitetin dhe legjislacionin e shtetit.⁶⁸

Në të njëjtën kohë me rivendosjen e brendshme të Islamit, u shfaq një projekt ndërkombëtar pan-islamik, duke përdorur mjetet bashkëkohore të së drejtës ndërkombëtare. Kështu, feja e politizuar u gjet në dy nivele: vendore dhe ndërkombëtare. Në nivel ndërkombëtar, institucioni kryesor për zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare të bazuar në Islamin e politizuar është Organizata e Bashkëpunimit Islamik (OBI), më parë Organizata e Konferencës Islamike. Pas zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare islame të OBI qëndron argumenti se e drejta e përgjithshme ndërkombëtare nuk merr parasysh vlerat dhe traditat islame dhe se Islami nuk është i vendosur në praktikën e së drejtës ndërkombëtare. Ky argument korrespondon me pjesët e kritikave të qasjes në botën e tretë ndaj të drejtës ndërkombëtare (TWAIL), të cilat kritikojnë veçanërisht përdorimin politik dhe abuzimin e të drejtës ndërkombëtare nga vendet në perëndim. Megjithatë, OBI përballlet me vështirësi kur bëhet fjalë për paraqitjen e një qasjeje alternative ndaj të drejtës ndërkombëtare që mund të përshtatet me nevojat pluraliste në shoqëritë, për të cilat ligji i OBI ka për qëllim të zbatohet.⁶⁹

Me 57 shtete anëtare në katër kontinente, OBI përfshin një shumëllojshmëri të sistemeve kulturore dhe socio-politike me nivele të ndryshme të zhvillimit ekonomik dhe demokratik. Vendimet merren nga ministrat e jashtëm të shteteve anëtare bazuar në kornizën e politikave të quajtur programe veprimi dhjetë-vjeçare, të krijuar nga Samiti Islamik. Për nga stuktura, OBI ngjason me disa korniza institucionale të OKB-së. Sekretariati i OBI, përgjegjës për aktivitetet e përditshme të organizatës, aktualisht është nën udhëheqjen e turkut Ekmeleddin Ihsanoglu si

⁶⁸ A.Tadjini, Konstitucionalizimi i Islamit në Afganistan, Iran dhe Irak - Një hap prapa për pozitën e të drejtave të njeriut? Zhurnali Nordik për të Drejtat e Njeriut, 2011-04, f. 353-369

⁶⁹ Azin Tadjini, Organizimi i Bashkëpunimit Islamik dhe Sfidat Rajonale për të Drejtën dhe Sigurinë Ndërkombëtare, Amsterdam Law Forum, VOL 4:2, f.36

Sekretar i Përgjithshëm. Me të, OBI ka zhvilluar një profil më të butë dhe më liberal krahasuar me disa nga linjat konfrontuese të paraardhësve të tij, por si sekretar i përgjithshëm ai nuk ka ndikim thelbësor në politikat e OBI.

Arsyeja për krijimin e OBI shpesh shpjegohet duke treguar nevojën për solidaritet musliman pas dy ngjarjeve në historinë e kohëve të fundit: humbja arabe e Luftës gjashtëditore në vitin 1967 dhe sulmi me zjarrvënie në 1969 kundër xhamisë Al-Aqsa, vend i shenjtë në Islamin Sunni. Si rezultat i këtyre dy incidenteve, OBI u krijua për të mbrojtur interesat e botës muslimane.

Organizata e Bashkëpunimit Islamik (OBI) njihet si "zëri kolektiv i botës muslimane". E përbërë nga 57 shtete anëtare, ajo është organizata e dytë më e madhe ndërqeveritare në botë pas OKB-së. E themeluar më 25 shtator 1969, dhe më pas e njohur si Organizatën për Bashkëpunim Islamik, për shumë njerëz në botën muslimane përbënte përmbushjen e një ëndrrë të përgjeshme që do të rezultonte në një Ummet të bashkuar, i aftë të qëndronte për të drejtat e tij në në skenën botërore.

Megjithatë, 47 vjet pas themelimit të saj, OBI ka arritur pak në avancimin e interesave muslimane në skenën ndërkombëtare. Në fakt, ajo është cunguar pak më shumë sesa një entitet ceremonial i aftë vetëm për mbajtjen e konferencave. Karta e OBI është ambicioze dhe përfshin një listë gjithëpërfshirëse të objektivave, të cilat kërkojnë që organizata të koordinojë, promovojë dhe mbrojë pozicionet e unifikuara të vendeve muslimane në forume ndërkombëtare dhe të mbrojë imazhin e vërtetë të Islamit dhe të luftojë shpifjen e fesë. Megjithatë, pamundësia e OBI për të ndërmarrë veprime konkrete për shkaqet e rëndësishme për ummetin musliman ka çuar në zhgënjim me organizimin në mesin e muslimanëve të botës dhe ka bërë që shumë njerëz të vënë në dyshim ekzistencën e saj.

Megjithatë, pavarësisht nga paaftësia e kaluar për të përfaqësuar në mënyrë adekuate interesat muslimane në arenën ndërkombëtare, organizata akoma mund të rritë dhe të luajë një rol të madh për muslimanët në çështjet botërore. Duke pasur parasysh islamofobinë që po rritet në perëndim, ekziston nevoja që OBI t'i kundërvihet në mënyrë efektive ndjenjës anti-islamike që mbizotëron në Perëndim.

Sidoqoftë, duke shikuar historinë e trazirave në Lindjen e Mesme, vërehet një forcë shtytëse më e rëndësishme: politika mbrojtëse e Arabisë Saudite ndaj valës së nacionalizmit laik të përzier me socializëm, e dalë në një numër vendesh në rajon. Në periudhën pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore deri në vitet 1960, organizata kryesore e rajonit – Liga e Shteteve Arabe - ishte e udhëhequr nga regjimet pan-arabe dhe laike-nacionaliste, dhe si institucion ishte i paprekshëm nga ndikimi i Arabisë Saudite.⁷⁰ Në përpjekje për të kundërshtuar këtë zhvillim, konservatorizmi pan-islamik u bë diskurs për të luftuar pan-arabizmin. Përpjekja e parë për të institucionalizuar këtë agjendë rezultoi në Ligën Botërore Muslimane, e cila mbështeti Vëllazërinë Myslimane të Egjiptit si një forcë anti-Nasser dhe anti-radikale. Pas këtij suksesi, në vitin 1969 u krijua Organizata e Konferencës Islamike⁷¹ si një kornizë më pak ndikuese për bashkëpunim ndërkombëtar. Objektivi i krijimit të OBI në masë të madhe ka qenë i suksesshëm, në të shumtën e rasteve me ndihmën e kontributeve të mëdha financiare nga Arabia Saudite në buxhetin e saj që nga fillimi i organizimit. Përveç kësaj, gjatë viteve 1970 dhe 1991, vendeve të OBI iu ndane 96 miliardë dollarë në kredi dhe grante nga Arabia Saudite si një politikë monetare për pajtueshmëri. Gjatë kësaj periudhe, vendi mbështeti Irakun në luftën me Iranin, muxhahidinët afganë dhe Frontin e Shpëtimit Islam në Algjeri. Për më tepër, Arabia Saudite është selia e shumë prej organeve ndihmëse, si dhe institucioneve të specializuara dhe të lidhura të OBI.

